



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR

DOKUMENTI I NISMËS
PËR HARTIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR
(PPV) TË BASHKISË MALLAKASTËR

KRYETARI
Z. Agim KAPLLANAJ





PËRMBAJTJE

1. Hyrje
2. Analiza, qëllimi dhe nevoja për hartim të dokumentit të planifikimit;
3. Përcaktime për Zonat e Rëndësisë Kombëtare;
4. Kufijtë e territorit të njësisë vendore;
5. Plani i veprimeve për hartimin e dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor;
6. Mënyra e miratimit të PPV: në një apo dy ndalesa,
7. Përmbajtja e dokumenteve përbërëse të PPV-së;
8. Ekspertët që do të përbëjnë grupin e punës që do të hartojnë PPV-në;
9. Përcaktime për Forumin Këshillimor të Planit;
10. Përcaktime për procesin e bashkërendimit, këshillimit dhe takimeve publike dhe afatet përkatëse;
11. Buxheti për hartimin e PPV-së;
12. Zhvillimi në territorin e bashkisë deri në miratimin e PPV



HYRJE

Bashkia Mallakastër shtrihet në jug-perëndim të Shqipërisë, është pjesë e Qarkut Fier dhe ka një sipërfaqe prej 329.19 km². Qendra e bashkisë është qyteti i Ballshit. Ajo kufizohet në veri nga bashkia e Patosit dhe bashkia e Roskovecit, në lindje me bashkinë e Beratit dhe bashkinë e Memaliaj, në perëndim me bashkinë e Fierit dhe me bashkinë e Selenicës dhe në jug me bashkinë e Selenicës dhe bashkinë e Memaliaj. Kjo bashki përbëhet nga 9 (nëntë) njësi administrative, të cilat janë: Njësia Administrative Ballsh, Qendër Dukas, Greshicë, Aranitas, Hekal, Ngraçan, Kutë, Fratar, Selitë. Bashkia e Mallakastrës, në bazë të statistikave të vitit 2011 sipas Censurit regjistron 27.062 banorë dhe densitet prej 82.2 banorë/km², ndërsa sipas Regjistrit të Gjendjes Civile 43.033 banorë.

Ky dokument paraqet një panoramë të përgjithshme të gjendjes ekzistuese të territorit të Bashkisë Mallakastër dhe nevojës së hartimit të dokumentit të sipër përmendur, krahas kërkesës ligjore për hartimin e këtij dokumenti. Në këtë dokument paraqitet gjithashtu dhe plani i veprimeve që do të ndërmerret deri në miratimin përfundimtar të planit të zhvillimit të territorit të Bashkisë Mallakastër.

Bashkia Mallakastër synon të krijojë një mjedis institucional, ekonomik dhe social për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit. Për të realizuar këtë qëllim nevojitet garantimi i transparencës në planifikimin dhe zhvillimin e territorit, si dhe në proceset ligjore që i rregullojnë ato.

Për të realizuar këto objektiva, do të zbatohen një sërë politikash. Një ndër to është nisja e punës për hartimin dhe miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV), si përkthim i strategjisë vendore të zhvillimit në territor dhe bazë për zhvillimin e qëndrueshëm, investimet dhe kontrollin e territorit. PPV është dokumenti i planifikimit, që shtrihet në të gjithë territorin e Bashkisë Mallakastër, ndërkohë që "planifikimi i territorit" në vetvete është një veprimtari ndërdisiplinore për planifikimin e përdorimit të tokës, përcaktimin e kushteve për zhvillimin e territorit dhe të strukturave natyrore e të ndërtueshme në të. Në vijim të këtyre termave vlen të nënvizohet se "politikat territoriale" përbëjnë aktin më të lartë të planifikimit të territorit, me anë të të cilit realizohen programet dhe veprimtaritë në këtë fushë, për të arritur objektiva e qëllime të identifikuar. Ky proces do të bazohet në Ligjin Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit" si dhe legjislacionin sektorial në fuqi.

1. ANALIZA, QËLLIMI DHE NEVOJA PËR HARTIM TË DOKUMENTIT TË PLANIFIKIMIT



- **Analiza e situatës ekzistuese** (*Vendndodhja gjeografike dhe klima; Gjendja mjedisore; Të dhënat social ekonomike; Zhvillimi i territorit*);

Bashkia Mallakastër ndodhet në jug-perëndim të Shqipërisë, në një zonë kodrinore, e cila karakterizohet nga klima mesdhetare me dimër jo shumë të ftohtë dhe të lagësht dhe me verë të nxehtë dhe të thatë. I gjithë territori i bashkisë Mallakastër karakterizohet nga kodra me lartësi 200-300 m mbi nivelin e detit, të mbuluara kryesisht nga shkurre dhe pyje të larta të cilat janë të gjelbëruara gjatë gjithë vitit. Rrjeti hidrografik është i pasur me përrenj të shumtë, lumenj, liqene natyral dhe artificial si dhe burime të shumta ujore. Popullsia gjatë viteve të fundit është ulur ndjeshëm për shkak të emigracionit si dhe migracionit. Shkak për lëvizjen e popullsisë nga Mallakastra drejt qyteteve të tjera brenda vendit si dhe jashtë Shqipërisë janë mundësitë e pakta ekonomike si dhe infrastruktura rrugore e cila lë shumë për të dëshiruar. Terreni dhe shpërndarja e fshatrave në të gjithë territorin krijojnë vështirësi në lidhjen midis tyre. Ekonomia përbëhet nga industria e nxjerrjes dhe përpunimit të naftës, e cila është dhe një ndër burimet kryesore ekonomike të popullsisë vendase. Bujqësia është e përqendruar kryesisht në ferma të vogla individuale të cilat prodhojnë më tepër për konsum vetjak dhe shumë pak për tregtim. Për tregtim kryesisht shkojnë kulturat bujqësore si ulliri dhe nën produktet e tij si dhe qershia etj. Blegtoria është një tjetër fushë që ndikon në zhvillimin ekonomik të gjithë Mallakastrës, por edhe kjo si bujqësia përdoret më shumë për konsum vetjak dhe shumë pak për tregtim. Në disa pjesë të tjera të bashkisë Mallakastër siç janë fshatrat Aranitas, Visokë etj. është e mundur shfrytëzimi i territorit për gurorë, karriera kryesisht për gurin gëlqeror, rërën bituminoze, çakëll, etj dhe shfrytëzimi i këtyre pasurive natyrore ndikon sadopak në rritjen ekonomike të zonës. Terreni i vështirë si dhe ekonomia jo shumë e zhvilluar ndikojnë në gjendjen socio-ekonomike të popullsisë, për të cilën mund të themi se qytetarët e bashkisë Mallakastër kanë vështirësi të mëdha në jetesën e përditshme. Territori i Mallakastrës është i zhvilluar në mënyrë disi kaotike. Ai karakterizohet nga ndërtesa jo shumë të larta (ndërtesa prej 4-5 katesh) të cilat janë të përqendruar në qytetin e Ballshit si dhe shtëpi banimi të përbëra prej një ose dy katesh të cilat karakterizojnë zonat rurale). Mbas viteve 90' territori u zhvillua në mënyrë të çrregullt duke ndërtuar pa kriter, pa respektuar kushtet urbanistike, pa leje ndërtimi si dhe pa pasur informacion mbi kushtet gjeologjiko-inxhinierike të tokës ku ata po ndërtonin pasi këto objekte banimi nuk janë ndërtuar vetëm në tokën truall, por edhe në toka arë, kullota etj. Ajo që vlen për tu theksuar është se në disa zona banesat janë zhvendosur nga zonat kodrinore drejt fushave (siç janë fusha e Mollaj, Rromsit etj). Veç kësaj vlen për t'u përmendur se këto banesa janë të ndërtuara afër lumenjve, përrenjve, por edhe afër zonave naftëmbajtëse, afër Kombinatit të Përpunimit të Thellë të Naftës në qytetin e Ballshit, afër puseve të naftës nëpër fshatra, etj.

Sa i përket infrastrukturës rrugore, bazuar në inventarin e propozuar nga qeveria për rrugët rajonale dhe rurale të bashkive të reja mbas reformës administrative-territoriale, zona e Mallakastrës ka në total 452.9 km rrugë nga të cilët rreth 88.7 km janë rrugë rajonale-rurale. Në tabelat e mëposhtme jepet informacion më i detajuar në lidhje me distancat e fshatrave apo të Njësi Administrative nga qendra e bashkisë që është qyteti i Ballshit.

Distanca nga qyteti i Ballshit në njësit administrative dhe fshatrat e Mallakastrës¹

Nr	Distanca nga Qyteti i Ballshit – në fshatrat e Njësisë Administrative Qendër				
	Qendra	Fshati	Km	Gjendja e Rugës	Rrëz/Km
1	Ballsh	Lavdan	2.2	Rrëz Bituminoze	1
2	Ballsh	Usojë	2.3	Rrëz Bituminoze	1.5
3	Ballsh	Kash	4	Rrëz Bituminoze	1
4	Ballsh	Dukas	2.5	Rrëz Bituminoze	0.5
5	Ballsh	Drenovë Fushë	3	Asfalt	0
6	Ballsh	Lapulec	6	Asfalt	0
7	Ballsh	Ngrançie	7	Rrëz Bituminoze	2
8	Ballsh	Belishovë	7.5	Rrëz Bituminoze	3
9	Ballsh	Drenovë	6	Rrëz Bituminoze	0
10	Ballsh	Drenovë E Re	4	Rrëz Bituminoze	2
11	Ballsh	Visokë	7	Rrëz Bituminoze	2
12	Ballsh	Lofkënd	8	Asfalt	0
13	Ballsh	Belistan	12	Rrëz Bituminoze	8
	Totali		71.5	Totali	21

Tabela 1- Distanca e fshatrave të NJ.A.Qendër nga qyteti i Ballshit

1

Nr	Distanca nga Qyteti i Ballshit – në fshatrat e Njësisë Administrative Aranitas						
	Qendra	Fshati	Km	Gjendja E Rugës	Rrëz	Çakëll	Dhe
1	Ballsh	Aranitas	7.4	Asfalt	0	0	0
2	Ballsh	Kalenjë	7	Asfalt	0	0	0
3	Ballsh	Metoh	13	Çakëll/Dhe	0	6	0
4	Ballsh	Panahor	5	Rrëz Bituminoze	1.2	0	0
5	Ballsh	Çyçen	4	Çakëll/Dhe	0	1	0
6	Ballsh	Cfirë	13	Rrëz/Çakëll/Dhe	0	2.5	
7	Aranitas	Cfirë	8	Çakëll/Dhe	0	4	4
8	Cfirë	Metoh	4	Dhe	0	0	4
	Totali		61.4	Totali	1.2	13.5	8

Tabela 2- Distanca e fshatrave të NJ.A.Aranitas nga qyteti i Ballshit

Nr	Distanca nga Qyteti i Ballshit – në fshatrat e Njësisë Administrative Selitë						
	Qendra	Fshati	Km	Gjendja E Rugës	Rrëz	Çakëll	Dhe
1	Ballsh	Kapaj	20	Çakëll	0	5	0
2	Ballsh	Çërril	22.5	Çakëll/Dhe	0	3	2
3	Gjerbës	Selitë	6.5	Çakëll/Dhe	0	5	1.5
4	Ballsh	Gjerbës	12.5	Çakëll/Dhe	0	4	1
	Totali		84.5	Totali	0	22	4.5

Tabela 3- Distanca e fshatrave të NJ.A.Selitë nga qyteti i Ballshit

¹ Burimi I informacionit: Drejtoria e Infrastrukturës, Bashkia Mallakastrë

Nr	Distanca nga Qyteti i Ballshit – në fshatrat e Njësia Administrative Greshicë						
	Qendra	Fshati	Km	Gjendja E Rrugëve	Asfalt	Rërë	Dhe
1	Ballsh	Greshicë	13	Asfalt/Rërë Bituminoze	10.2	2.8	0
		Totali	13	Totali	10.2	2.8	0

Tabela 4- Distanca e fshatrave të NJ.A.Greshicë nga qyteti i Ballshit

Nr	Distanca nga Qyteti i Ballshit – në fshatrat e Njësia Administrative Fratar						
	Qendra	Fshati	Km	Gjendja E Rrugës	Rërë	Çakëll	Dhe
1	Ballsh	Fratar	19	Asfalt	0	0	0
2	Fratar	Kapaj	7	Asfalt	0	0	0
3	Fratar	Kremenar	4	Çakëll	0	4	0
4	Fratar	Bejar Lgj Tatoshaj	4.5	Rërë Bituminoze	1.6	0	0
5	Fratar	Bejar	5	Rërë Bituminoze	1.6	0	0
6	Fratar	Bejar Lgj Zaimaj	5	Çakëll/Rërë Bituminoze	1.5	1	0
7	Fratar	Bejar-Ninësh	7	Çakëll	0	2.5	0
8	Fratar	Ninësh	5	Çakëll	0	5	0
9	Fratar	Malas	7	Çakëll	0	0.7	0
10	Fratar	Gadurovë	8	Çakëll	0	8	0
11	Fratar	Drizar	4	Asfalt	0	0	0
		Totali	75.5	Totali	4.7	21.2	0

Tabela 5- Distanca e fshatrave të NJ.A.Fratar nga qyteti i Ballshit

Nr	Distanca nga Qyteti i Ballshit – në fshatrat e Njësia Administrative Kutë						
	Qendra	Fshati	Km	Gjendja e Rrugës	Rërë	Çakëll	Dhe
1	Ballsh	Kutë	31	Rërë Bituminoze	8	0	0
2	Ballsh	Çorrush	32	Rërë Bituminoze	6	0	0
3	Kutë	Çorrush	10	Çakëll	0	0	10
4	Kutë	Drizar	4	Çakëll	0	4	0
			87		14	4	10

Tabela 6- Distanca e fshatrave të NJ.A.Kutë nga qyteti i Ballshit

Nr	Distanca nga Qyteti i Ballshit – në fshatrat e Njësia Administrative Hekal						
	Qendra	Fshati	Km	Gjendja e Rrugës	Rërë	Çakëll	Dhe
1	Ballsh	Hekal	7	Asfalt	0	0	0
2	Hekal	Klos	3	Rërë Bituminoze	3	0	0
3	Hekal	Poçem	13	Çakëll	0	8	0
4	Klos	Poçem	4	Çakëll	0	4	0
5	Ballsh	Rromës	17	Çakëll	0	11	0
6	Hekal	Mollaj	7	Çakëll	0	7	0
7	Povël	Poçem	9	Çakëll	0	9	0
		Totali	60	Totali	3	39	0

Tabela 7- Distanca e fshatrave të NJ.A.Hekal nga qyteti i Ballshit

Nr	Distanca e Km Totali						
	Qendra	Fshati	Km	Asfalt	Rërë	Çakëll	Drejtë
	Ballsh	Dukas	75.5	17	21	0	0
	Ballsh	Aranitas	61.4	14.4	1.2	13.5	0
	Ballsh	Selitë	84.5	0	0	22	0
	Ballsh	Greshicë	13	0	5	0	0
	Ballsh	Fratar	75.5	11	4.7	21.2	0
	Ballsh	Kutë	87	0	20	4	10
	Ballsh	Hekal	60	7	3	39	10
	Visokë	Malas	0	35	0	0	0
			452.9	84.4	54.9	99.7	32.5

Tabela 8- Distanca e NJ.Administrative nga qyteti i Ballshit

Me ndërtimin e segmentit rrugor Levan-Tepelenë dhe vënien e saj në funksion, rruga nacionale që kalonte përmes qytetit të Ballshit, por edhe në disa qendra të tjera të banuara të kësaj bashkie ka humbur rëndësinë që kishte si aks nacional i trafikut që lidhte Shqipërinë qendrore me atë të jugut. Qarkullimi i mjeteve në këtë segment rrugor aktualisht është shumë i ulët. Kjo ka sjell që edhe gjendja fizike e këtij segmenti rrugor të degradojë me shpejtësi si rezultat i mosmirëmbajtjes.

Lidhja e qytetit të Ballshit, por edhe e disa qendrave të tjera administrative të kësaj bashkie me rrugën e re bëhet aktualisht një nevojë e rëndësishme për lidhjen e banorëve dhe bizneseve me arterien kryesore të trafikut për këtë rajon.

Problematike gjithashtu për Bashkinë Mallakastër është gjendja e rrugëve ekzistuese lidhëse midis njësive administrative, rrugët rurale (të brendshme) dhe nevoja për një konceptim të ri urban të hyrjes së qytetit dhe qendrës Ballsh.

- **Profili i bashkisë**



Figura 1- Harta e ndarjes administrative të Bashkisë Mallakastër

Bashkia e Mallakastrës shtrihet në jug-perëndim të Shqipërisë dhe është pjesë e qarkut Fier. Ajo përbëhet nga nëntë njësi Administrative të cilët kanë në përbërjen e tyre 1 njësi qendër (qyteti Ballsh) dhe 41 fshatra, me një popullsi prej 43.033 banorë.

Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Ballshit. Territori i bashkisë shtrihet në një zonë kodrinore në jug të Ultësirës Perëndimore dhe shërben si një zonë kalimtare midis kësaj të fundit dhe Krahut të Malore Jugore, me lartësi mbizotëruese 200 deri 300 metra mbi nivelin e detit. Pika më e lartë e krahinës është maja e Shëndëllisë (712 metra).



Sipërfaqja e territorit të Bashkisë Mallakastër është 329.19 km².

Qarku	Bashkia	Njësitë Administrative	Qytetet dhe Fshatrat ne përbërje te tyre
Fier	Mallakastër	Ballsh	Qyteti Ballsh
		Qendër Dukas	Fshatrat: Visokë, Belishovë, Belistan, Drenovë, Drenovë Fushë, Kash, Usojë, Ngrançie, Lavdan, Lapulec, Lofkënd, Dukas
		Greshicë	Fshatrat: Greshicë, Greshicë e Re
		Aranitas	Fshatrat: Aranitas, Panahor, Kalenjë, Cfir, Metoh, Çyçen
		Hekal	Fshatrat; Hekal, Klos, Mollaj, Rromës
		Ngraçan	Fshatrat; Ngraçan, Riban
		Kutë	Fshatrat; Kutë, Drizar, Anëbreg, Çorrush, Poçem
		Fratar	Fshatrat; Bejar, Damës, Gadurovë, Malas, Kremenar, Ninësh
		Selitë	Fshatrat; Selitë, Gjerbës, Kapaj, Çërrilë

Tabela 9: Ndarja Administrative e Bashkisë Mallakastër, 2015

Zona ka sipërfaqe të konsiderueshme me kullota dhe pyje dhe më pak tokë bujqësore (toke arë). Vend të rëndësishëm zë frutikultura (kultivohen pemë si qershia, dardha dhe fiku), vreshta dhe ullinjë. Bujqësia është sektori kryesor i ekonomisë lokale për punësim. Sektor tjetër është industria e nxjerrjes së hidrokarbureve, me vendburimet e pasura dhe rafineria e përpunimit në Ballsh, të cilat japin një kontribut në zhvillimin ekonomik të zonës dhe punësimin. Sektorë të tjerë të ekonomisë janë shërbimet, tregtia, ndërtimi, sektori bankar dhe telekomunikacioni.

Aktivitetet ekonomike kryesore (me peshë më të madhe) në njësinë administrative Ballsh (qyteti) referuar numrit të të punësuarve janë shërbimet që zënë 39.1% të totalit dhe industria (36.4%). Aktivitete të tjera janë tregtia, ndërtimi dhe më pak bujqësia.

Në Njësitë e tjera administrative, aktiviteti kryesor është bujqësia dhe pemëtaria (përfshirë ullinjë, vreshtat dhe frutikulturën), që varion nga 58.5% në Fratar në 91.4% në Ngraçan.

Sa i përket shpërndarjes demografike, Bashkia Mallakastër ka një popullsi urbane prej 28.2% (ku 100% e kësaj popullsie jeton në qytetin e Ballshit) dhe 71.8 % është popullsi rurale. Treguesit e popullsisë tregojnë se 62.1 % e popullsisë ka përfunduar arsimin 8-9 vjeçar, 26.8 % arsimin e mesëm si dhe 5.7% e popullsisë ka përfunduar studimet universitare dhe pas universitare.

Ekonomia kryesore përbëhet nga bujqësia e cila e shprehur në përqindje është 49.3 %, e ndjekur nga sektori i shërbimeve me 29.5 % si dhe në fund industria me 21.2 %. Ndërkohë që 62.7 % e popullsisë janë të vetëpunësuar dhe 37.3 % e popullsisë janë të punësuar me pagë. Raporti i punësimit meshkuj-femra është 55.11 % meshkuj të punësuar krahasuar me 22.5 % femra. Të dhënat në lidhje me papunësinë tregojnë se shkalla e papunësisë është 22.3 %.

Organi përfaqësues i Bashkisë është Këshilli Bashkiak, i cili përbëhet nga 21 anëtarë (16 meshkuj dhe 5 femra). Bashkia Mallakastër disponon dhe një faqe zyrtare në internet me adresë <http://www.bashkiamallakaster.gov.al>, në dispozicion për çdo qytetar. Në këtë mënyrë ata më informohen për çdo shërbim që ofron institucioni si edhe të shprehin ankesat, shqetësimet apo sugjerimet e tyre.



▪ **Faktorët kryesorë që çojnë në nevojën e menjëhershme për hartimin e këtij plani janë:**

- Mospasja e një dokumenti planifikimi në fuqi;
- Ndryshimi i kufijve administrativë të njësisë vendore në zbatim të reformës administrativo territoriale;
- Zhvillimi kaotik dhe përdorimi jo racional i tokës dhe burimeve natyrore;
- Papunësia dhe mospërputhje e profesioneve të ofruara me ato të kërkuara nga tregu i punës;
- Nivel i ulët i investimeve të huaja;
- Shumë zona me ndërtime në territorin e bashkisë nuk kanë infrastrukturë rrugore të duhur dhe shërbime të tjera publike (lagjet e reja);
- Sektorë të pazhvilluar përkundër potencialit relativisht të lartë: ekonomi, bujqësi etj;
- Nivel i ulët i industrisë përpunuese;
- Probleme të vazhdueshme me ujitjen dhe kullimin për një pjesë të madhe të tokave në fushë;
- Dëmtim të sipërfaqeve prodhuese nga ndërtimet private dhe industriale;
- Zënie të tokës publike për ndërtime private;
- Sipërfaqe toke të lëna djerrë;
- Nivel shumë i ulët i zhvillimit e agropërpunimit;
- Zona ekonomike nuk ka kushtet e nevojshme akses, infrastrukturë;
- Mungon transporti publik dhe transporti ndërqytetës nuk ka stacione të mirë përcaktuara;
- Vendbanimet dhe popullsia janë të shpërndara dhe bëjnë të vështirë ofrimin e shërbimeve;
- Kthimi i tokës bujqësore në truall urban dhe dëmtimi i sistemit të vaditjes;
- Mungesa e pemëve shkakton rrëshqitje të dheut dhe shtim të ndikimit të erës;
- Vendbanimet dhe popullsia janë të shpërndara dhe bëjnë të vështirë ofrimin e shërbimeve;
- Zhvillim i pa orientuar që nuk sjell asnjë avantazh konkurrues;
- Mirëmbajtje e dobët e rrjetit rrugor dhe hapësirave të gjelbra;
- Rrjeti aktual i kanalizimeve është i pamjaftueshëm dhe nuk ka një Impiant trajtimi të ujërave të zeza;
- Mungesa e aktiviteti në masat e mbrojtjes së mjedisit (menaxhimi i mbetjeve, ujërave të përdorura);
- Probleme të mjedisit; mbeturina urbane dhe kanalizime të papërshtatshme të ujërave të zeza të cilat ndikojnë tek turizmi ;
- Pamjaftueshmëri në furnizimin me ujë të pijshëm me pasoja për biznesin, turizmin dhe bujqësinë;
- Ndërtime pranë brezit lumor;
- Ndërtime pranë zonave nafte nxjerrëse dhe naftëmbajtëse;
- Ndërtime të realizuara më parë pranë zonave historike, kulturore dhe me rëndësi kombëtare;
- Zhvillimi i territorit, për krijimin e qendrave të reja me karakter turizmin dhe zhvillimin e biznesit, me qëllim gjenerimin e vendeve të reja të punës.

Arsyet për ndërmarrjen e nismës për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, lidhën si me kuadrin ligjor ashtu dhe me gjendjen ekzistuese të Bashkisë Mallakastër. Me Ligjin Nr. 115/2014, datë



31.7.2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” kufijtë administrativë të Bashkisë Mallakastër, përfshijnë tashmë një territor prej 329 km². Për rrjedhojë, hartimi i një Plani të Përgjithshëm Vendor është një domosdoshmëri përpara dinamikave të zhvillimit të këtij territori.

Plani i Përgjithshëm Vendor do të integrojë dhe trajtojë së bashku dhe në mënyrë të pandashme të gjitha njësitë administrative pjesë e Bashkisë Mallakastër.

Nga ana tjetër, Ligji 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, orienton të gjitha njësitë vendore në hartimin e planit. Në këtë mënyrë hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor vjen jo vetëm si detyrim ligjor por dhe si nevojë për zhvillimin e mëtejshëm dhe gjithëpërfshirës të territorit të Bashkisë Mallakastër.

Mbështetur dhe në rezultatet e analizave të mësipërme, Plani i Përgjithshëm Vendor, përmes planifikimit të kujdesshëm dhe zbatimit të instrumenteve përkatëse, do të tentojë të zgjidhë problemet ekzistuese që lidhen me çështjet e ndotjes së mjedisit, ajrit, ujërave nëntokësorë, zhvillimit informal etj. Nga ana tjetër, plani i zhvillimit adreson në mënyrë të veçantë dhe çështje të cilat lidhen me situatën social - ekonomike, ku nëpërmjet politikave të zhvillimit synohet nxitja e ekonomisë lokale dhe rajonale, ulja e nivelit të papunësisë dhe rritja e mirëqenies sociale dhe ekonomike.

Krahas problematikave të mësipërme, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Mallakastër, do të vendosë theksin në zgjidhjen e problematikave të lidhura me zhvillimin e territorit si informalitetit, humbja e tokave bujqësore, mungesa e infrastrukturave publike etj.

▪ **Qëllimi i këtij plani**

Duke ndjekur objektivat e përgjithshme të Ligjit për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit si dhe objektivat strategjike të programit qeveritar dhe të strategjive kombëtare sektoriale ky projekt ka si objektiv realizimin e një Plani të Përgjithshëm Vendor të qëndrueshëm që siguron menaxhimin e tokës nëpërmjet sigurimit të instrumenteve të planifikimit dhe kontrollit të territorit.

Objektivat specifike përfshijnë:

- Zhvillimin, futjen dhe aplikimin praktik të metodave planifikuese urbane lokale të detyrueshme që t'i përshtaten tregut;
- Kultivimin dhe formulimin e veprimtarive të partneritetit ndërmjet bashkisë ndërmarrjeve/agjencive të infrastrukturës, zhvilluesve, pronarëve të tokës, pushtetit qendror dhe grupeve të tjera të interesit nëpërmjet një procesi konsultimesh dhe pjesëmarrjes aktive;
- Rritjes së kapacitetit të planifikimit, kontrollit të zhvillimit dhe menaxhimit të tokës në departamentet përkatëse të pushtetit lokal.

Objektivat e Planit të Përgjithshëm Vendor janë:

1. Balancimi i nevojave dhe interesave kombëtare e vendore për zhvillimet në territor;
2. Krijimi i kushteve për një zhvillim të qëndrueshëm në territor;
3. Rregullimi i përdorimeve të tokës, intensitetin e shtrirjes së ndërtimit në sistemet natyrore, bujqësore dhe urbane të territorit;

4. Planifikimi i programeve dhe masave për të garantuar rigjenerimin urban, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, të tokës së kultivueshme, pejsazheve dhe hapësirave të gjelbra;
5. Rregullimi i vendndodhjes dhe programeve për infrastrukturën publike e servitutet publike;
6. Rregullimi i ruajtjes, përdorimit të zonave të mbrojtura natyrore dhe historike;



2. PËRCAKTIME PËR ZONAT E RËNDËSISË KOMBËTARE²

- **Zona me karakteristika të veçanta kulturore, historike, ekonomike, sociale ose mjedisor si dhe Zona që kanë përparësi zhvillimin e Turizmit**

Fshatrat e mëposhtëm nuk janë miratuar si zona me përparësi zhvillimin e turizmit, por bashkia Mallakastër i shikon si fshatra, ku turizmi mund të kthehet në një motor ekonomik për vet fshatrat dhe për bashkinë.

Fshati Hekal, është qendra e Njësisë Administrative Hekal. Ai ka një popullsi prej 4.817 banorësh. Në territorin e këtij fshati ndodhet Parku Arkeologjik i Bylisit i shpallur si i tillë me VKM Nr. 396, datë 31.3.2005. Të dhënat historike arkeologjike, natyrore agro-kulturore plotësojnë kriteret e një mjedisi turistik. Ndodhet 8 km nga qyteti Ballsh dhe 7 km nga segmentin rrugor Levan-Tepelenë. Së fundmi, fshati Hekal është bërë pjesë e programit të qeverisë shqiptare për rilindjen rurale “100 fshatrat”.

Fshati Çërril është pjesë e Njësisë Administrative Selitë dhe pozicionohet në pikën më të lartë të kodrave të krahinës së Mallakastrës. Fshati ka një peizazh shumë piktoresk, ku ndërthuret historia e banorëve në luftërat kundër reformave të Tanzimatit me në krye kapëdanin Orhan Bardhaj. Monumenti i natyrës, Lisi i Vakëfit, (shpallur me VKM Nr. 676, datë 20.12.2002) emri i të cilit lidhet me shenjtorët e fesë bektashiane, është simbol i këtij fshati. Në çdo stinë të vitit lisit nuk i bien gjethet. Bashkë me dy liqenet më të bukur dhe më të mëdhenj të zonës, rezervuarin Lumara 1 dhe rezervuarin Lumara 2, fshati Çërrile mund të hyjë në desitacionet më të reja turistike për vizitorët e huaj dhe vendas. Fshati Çërrile ndodhet, vetëm 25 km rrugë rurale të paasfaltuar larg qytetit të Ballshit.

Fshati Aranitas. I vendosur në rrëzë të malit Shëndëllisë 714 m të lartë, emri i të cilit lidhet me mbiemrin e feudalit të parë David Arianiti si dhe porositësit dhe qëndristarit të epitafit të Gllavinicës, Gjergj Arianiti, dhe me vetë shenjtërinë e 7 kishave në luginën e lumit Gjanicë. Toka ranore e shumë pjellore, me gjurmë arkeologjike të varrezave prehistorike në lagjen Bakaj, monument kulture kategoria I, plotësojnë të gjitha parametrat për zhvillimin e turizmit në këtë fshat vendosur vetëm 7km nga qyteti Ballsh.

Historia e fshatit Aranitas lidhet ngushtë me figurat historike të periudhës së Tanzimatit me kapëdan Zenel Xhafon (1847), me periudhën e pavarësisë me ushtarakun dhe ish ministrin e shtetit shqiptar Mustafa Aranitasi, me gjeneralin e parë shqipëtar Xhemal Arianiti, me shkrimtarin Mit’hat Araniti dhe Heroin e Popullit Ramiz Aranitasi.

² Burimi i informacionit: Legjislacioni për trashëgiminë kulturore “Parqet arkeologjike Kombëtare dhe Zonat Arkeologjike në Republikën e Shqipërisë”; Drejtoria e Institutit të Monumenteve të Kulturës në Ministrinë e Kulturës; Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore, Komisioni Kombëtar i UNESCO-s Tiranë; Libri “Bylis” i arkeolog Prof. Dr. Neritan Ceka e Prof. Skënder Muçaj; Libri “Historia e Shtetit Shqipëtar 1912-2005” i Prof. Kastriot Dervishi.



Fratari i Mallakastrës ndodhet në skajin e sipërm të kësaj krahine të madhe kufizohet me zonën e Beratit dhe Tepelenës. Përgjatë rrjedhës veriperëndimore të lumit të Povelës ndahet me një grumbull fshatrash po të Mallakastrës si Cërrila, Bardhaj, Kapaj, Gjerbës e Greshicë, ndërsa një varg fshatsh kodrinash, bregoresh dhe luginash e bashkojnë atë me Kremenarin, Drizarin, Kutën dhe Çorushin. Kështu Fratari lidhet e komunikon natyrshëm me shumicën e fshatrave të Mallakastrës së sipërme. Për sa i përket historikut të emrit “Fratar”, këtu e ka burimin edhe legjenda sipas së cilës “Fratar” shpjegohet me fjalën latine “Frateri” që do të thotë “vëllazëri”. Ekziston edhe një gojëdhënë tjetër në lidhje me këtë emër, sipas së cilës e gjithë zona ka qenë pronë e familjes fisnike “Matrënga”, të cilët ndërtuan një kështjellë të përforcuar mesjetare, një kishë, një varrezë si dhe lanë pas emrin e familjes “Matrënga”. Kur bota e krishterë po shpërbëhej dhe në Mallakastër po imponohej myslimanizmi me të gjitha format dhe mjetet që vinin nga pushtuesi turk, prifti “frati” i kishës së Kalamatrëngut mbledhte aty popullin dhe predikonte kundërshtonte me guxim ndërrimin e fesë shekullore. Turqit e kapën fratin e pabindur dhe e lidhën në lisin e madh të Kalamatrëngut. Me kalimin e kohërave vendi ku kishte shërbyer Frati u quajt i gjithë “vendi i Fratit”, u thjeshtëzua më vonë në “Frat” e më pas u artikulua në “Fratari”. Promotori i lëvizjes kombëtare shqiptare bashkë me vëllezërit Frashëri, rilindasi Hajredin Fratari do shënojë hapjen e shkollës së parë shqipe në Mallakastër në vitin 1906.

Fshati Poçem (Pika Turistike). Poçemi dhe lugina e Vjosës janë një tjetër atraksion turistik, që marrin me vete simpatinë e vizitorëve të huaj dhe shqiptarë. Burimi, furnizuesi me ujë të pijshëm i fshatrave dhe qytetit të Ballshit. Rreth 400 vjeçarë janë shpallur monument natyre me VKM Nr. 676, datë 20.12.2002 dhe kanë potencial për të qënë një magnet turistik pranë luginës së Vjosës. Tre ngjarjet e rëndësishme historike të 14 Korrikut, ajo e vitit 1847, 1920 dhe 1943 pasurojnë historiografinë Mallakastër nëpërmjet figurave historike, që në themel kanë patriotizmin dhe miqësinë me krahinën e Vlorës dhe Tepelenës. Fshati Poçem ndodhet 300 metra nga rruga nacionale Levan-Tepelenë, 7 km nga Parku arkeologjik i Bylisit dhe 12 km nga qyteti i Ballshit.

○ Monumentet e Kulturës



REJA BASHKIA

Lista e monumenteve të kulturës ³					
Nr.	Emërtimi i monumentit	Kateg.	Adresa		Të dhëna të shpalljes
			Fshati	NJA	Institucioni/ Nr. vendimit/ Data
1	Rrënojat e Klosit	I	Klos	Hekal	- Instituti i Shkencave, Vendim Nr.95, datë 16.10.1948; - Rrektorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Vendim Nr. 6, datë 15.01.1963; - Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Vendim Nr.1886, datë 10.06.1973.
2	Kalaja e C'firit	I	C'fir	Hekal	- Instituti i Shkencave, Vendim Nr.95, datë 16.10.1948; - Rrektorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Vendim Nr. 6, datë 15.01.1963; - Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Vendim Nr.1886, datë 10.06.1973.
3	Qyteti ilir i Bylisit	I	Hekal	Hekal	- Instituti i Shkencave, Vendim Nr.95, datë 16.10.1948; - Rrektorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Vendim Nr. 6, datë 15.01.1963; - Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Vendim Nr.1886, datë 10.06.1973.
4	Varrezat ilire në Bakaj, Aranitas	I	Aranitas	Aranitës	Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Vendim Nr.1886, datë 10.06.1973.
5	Lisat e Kalenjës (varrezë mesjetare)	I	Panahor	Aranitës	- Rrektorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Vendim Nr. 6, datë 15.01.1963; - Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Vendim Nr.1886, datë 10.06.1973.
6	Banesa e Selim Shehaj	I	Kutë	Kutë	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, Drejtoria e Kulturës, Vedim Nr. 266/1, datë 16.02.1979
7	Banesa e Temo Çelajt (ish Bilbil Klosi), ku në prill të vitit 1943 ka punuar shoku E. Hoxha	I	Klos	Hekal	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, Drejtoria e Kulturës, Vedim Nr. 266/1, datë 16.02.1979
8	Banesa e Qazim Yzeiraj bashkë me dy perdhesat pranë saj	I	Aranitas	Aranitas	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, Drejtoria e Kulturës, Vedim Nr. 266/1, datë 16.02.1979

Tabela 10- Tabela me monumentet e kulturës në Bashkinë Mallakastër

○ Zonat e parqet arkeologjike

Lista e zonave të mbrojtura			
Nr.	Emërtimi i zonës	Adresa	Të dhëna të shpalljes
		Njësia admin.	Institucioni/ Nr. vendimit/ Data
1	Kufijtë dhe rregullorja e administrimit të Parkut Arkeologjik të Bylisit; 2. për disa ndryshime në vendimin nr. 396, dt. 31.03.2005, të keshillit të ministrave "për miratimin e kufijeve dhe rregullores së administrimit të parqeve arkeologjike të Shkodrës, Lezhës, Apolonisë, Bylisit, Amantias, Orikumit, Antigonesë, Finiqit dhe Butrintit", të ndryshuar dhe vkm 163 dt. 27.02.2013	Hekal	- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 396, datë 31.3.2005 - Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.249, datë 30.04.2014 "Për disa ndryshime në vendimin Nr. 396, datë 31.03.2005, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kufijeve dhe rregullores së administrimit të parqeve arkeologjike të Shkodrës, Lezhës, Apolonisë, Bylisit, Amantias, Orikumit, Antigonesë, Finiqit dhe Butrintit", të ndryshuar dhe VKM Nr. 163, datë 27.02.2013
2	Zona e mbrojtur "Rrënojat bazilikës paleokristiane dhe kishës së Shën Mërisë"	Ballsh	M.T.K.R.S, Drejtoria e Përgjithshme e Turizmit dhe Trashëgimisë Kulturore, Vendim Nr.598, datë 09.12.2010
3	Zona e mbrojtur e rrënojave të Klosit, muret brenda dhe jashtë tyre me një distancë rreth 10 m rreth tyre.	Hekal	Instituti i Shkencave, Vendim Nr.95, datë 16.10.1948.
4	Zona e mbrojtur e kalasë së C'firit, muret brenda dhe jashtë tyre me një distancë prej 10 m për rreth.	Hekal	Instituti i Shkencave, Vendim Nr.95, datë 16.10.1948.

Tabela 11- Tabela me zonat e mbrojtura në Bashkinë Mallakastër

³ Burimi i informacionit:Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, qarku Fier

Parku Arkeologjik Bylis

I ndodhur 5 km nga qyteti Ballsh, Parku Arkeologjik ka një sipërfaqe prej 30 ha. Qyteti antik ilir i Bylisit u themelua nga fisi ilir i bylinëve në vitet 400-375 p.e.s. dhe ka qenë i banuar deri në fund të shek. VI e. s. Bylisi ka qenë qendra e fisit ilir të bylinëve, të cilët në antikitet banonin në territorin e Mallakastrës së sotme. Themelimi i Bylisit, ndërkohë që 1,5 km larg tij kishte një qytet ilir i quajtur Nikaja i themeluar gati një shekull më parë, dëshmon fuqinë ekonomike të bylinëve dhe zhvillimin e jetës qytetare në këtë rajon. Bylisi është përfaqësuesi më i denjë i qytetërimit ilir. Qyteti preu në shek. II-I p.e.s. monedhat e veta të destinuara për bashkësinë byline dhe për qytetin gjë që e dëshmon Bylisin si kryeqendër e bashkësisë byline ku bënë pjesë edhe qytetet e Nikajës (fshati i sotëm Klos 1,5 km nga Bylisi), qytetet ilire në Margëlliç dhe Gurzezë dhe disa fortifikime dhe fshatra antike.




Fig. 1 Parku Arkeologjik i Bylisit

a) Muri rrethues i periudhës helenistike, mesi shek. IV p.e.s. me gjatësi 2.250 m, lartësi 9 m dhe gjerësi 3,50 m mbronte një sipërfaqe prej 30 ha. Muri ishte pajisur me 6 porta të cilat mbroheshin nga kulla që ngriheshin mbi harkun e korridorit të hyrjes.

b) Teatri, kapaciteti 7.500 vende, ruhen pjesërisht shkallarja, skena, hyrjet. Teatri i Bylisit është një monument i mesit të shek. III p. e. s. i ndërtuar në këndin juglindor të agorasë së qytetit antik.

c) Stadiumi është një nga monumentet kryesore të agorasë i ndërtuar gjatë shek. III p.e.s. dhe bënë pjesë në monumentet e rralla të këtij lloji në qytetet tona antike (pas stadiumit të Amantias). Ai ka shtrirje veri jug me gjatësi 134 m dhe përbëhej nga 19 shkallë me lartësi 30 cm dhe gjerësi 0,40 m gjë që pre supozon se spektatorët qëndronin në këmbë gjatë garave.

ç) Katedralja, sipërfaqja 4.000m² përbëhej nga Bazilika, baptisteri dhe kompleksi peshkopal. Ajo ka filluar të ndërtohet në fund të shek. IV e. s. dhe është plotësuar dhe rindërtuar deri në vitin 547. Ajo përfaqëson

kompleksin arkitekturor më të rëndësishëm të periudhës së antikitetit të vonë jo vetëm në Bylis por edhe më gjerë.

d) Bazilika A, sipërfaqja 86 5 m² është ndërtuar në skajin jugor të stoas së madhe. Ajo është trenefshe dhe ka përmasa 38,22 x 23,42 m dëshmi e një bazilike monumentale. Bazilika A është ndërtuar në gjysmën e parë të shek. V dhe është shkatërruar nga dyndjet barbare të viteve 547-548.



dh) Bazilika C, sipërfaqja 752 m² është një monument i ndërtuar në ¼ e dytë të shek.VI e.s. në arën perëndimore të qytetit. Me përmasa 33x22,80 m ajo renditet ndër bazilikat me përmasa mesatare.

Bazilika D, sipërfaqja 1.183 m² është trenefshe, ka përmasa 45,25x 26,15 m dhe është ndërtuar në fillim të shek.VI e.s.

e) Bazilika E, sipërfaqja 752 m² ashtu si dhe ajo D gjendet jashtë murit të Viktorinit. Ajo është një bazilikë trenefshe me përmasa 33 x 22,80 m. Dyshemeja e sanktuarit është shtruar me mozaik. Skulptura dekorative e bazilikës E dallohet nga ajo e bazilikave të tjera të Bylisit.

ë) Muri i Viktorinit. Ndërtuar në vitet 551-556. Gjatësia-625,80 m nga të cilat faqja veriore 69 m dhe faqja lindore 556,80 m, Gjerësia – 2,30 m, Lartësia – 8- 9 m.

f) Qyteza byline e Belishovës. Qyteza e fortifikuar e Belishovës ndodhet në majën e një kodre mbi fshatin me të njëjtin emër. Ajo është ndërtuar në shek.VI p.e.s. dhe ndodhet në krahun e majtë të rrugës nacionale Ballsh-Fier. Kalaja e Belishovës ishte një qendër e vogël qytetare e cila kishte funksione të ndryshme. Ajo shërbente si pikë mbrojtëse përgjatë rrugës antike Apolloni-Gurzëzë-Bylis dhe njëkohësisht si qendër qytetare për banorët përfaqar saj.


g) Kalaja byline e Cfirit. Pas themelimit të Bylisit duket se një seri kalash dhe qyteza të fortifikuara siguronin mbrojtjen e qytetit dhe rrugët e komunikimit. Një nga këto kala ishte ndërtuar në majë të kodrës së Cfirit në veri të territorit bylin. Kjo kala e ndërtuar në shek.IV p.e.s. duket se mbronte rrugën që lidhte Bylisin me qytetet ilire Dimal dhe Antipatrea.

gj) Qendra peshkopale, Bazelika Ballsh. Sipas dëshmimeve arkeologjike, pas rënies së qytetit antik të Bylisit një pjesë e banorëve të tij midis tyre dhe peshkopi i qytetit u vendosën në Ballsh. Fillimisht u ndërtua një bazilikë peshkopale, e cila shënon dhe fillesën e qytetit të Ballshit. Qyteti filloi të njihej me emrat Kefaloni, Gllavinicë dhe Peshkopi. Meqenëse peshkopata e Ballshit ishte një institucion i rëndësishëm i fesë kristiane, përfaqar saj u ndërtuan banesa duke krijuar kështu një vendbanim të ri. Për gati 12 shekuj peshkopata e Ballshit ishte ndër më të rëndësishmet, duke e shndërruar Ballshin rrjedhimisht në një qendër me rëndësi për krahinën e Mallakastrës. Pagëzimi në këtë peshkopatë i carit bullgar Boris në vitin 865, qëndrimi në të i prijësit të normanëve Robert Guiskardi në vitin 1081 dhe më pas i Boemundit në vitin 1108, përbëjnë disa nga dëshmitë e rëndësishme të Ballshit në këtë periudhë. Në vitin 1210 Ballshi bie nën sundimin venedikas. Edhe gjatë sundimit osman Ballshi ishte një qendër e rëndësishme e krishterimit deri në vitin 1750, kur epitafi i Gllavinicës, një pjesë e ikonave të saj dhe disa libra të shenjtë-kodikë u transferuan në mitropolinë e Beratit. Pas kësaj kohe rëndësia e Ballshit bie.

Qyteti antik Nikaja, Klos

I ndodhur 1.5 km në jug të Bylisit, pranë fshatit Klos, ai ka një sipërfaqe prej 18 ha. Themeluar në fund të shek.V p.e.s., qyteti ka qenë i banuar deri në shek.II e.s. dhe Nikaja është ndër qytetet më të hershme ilire. Ai u themelua nga banorë të fisit ilir të bylinëve që banonin në krahinën e Mallakastrës gjatë antikitetit. Gjurmët e shumta të banimit që nga epoka e neolitit të mesëm në Cakran e në vijim me vendbanime të periudhës së bronzit në Margëlliç, të periudhës së hekurit në Lofkënd dhe vendbanime të periudhës arkaike në një sërë fshatrash, dëshmojnë nivelin relativisht të lartë të zhvillimit të krahinës së Mallakastrës që në këtë kohë. Niveli më i lartë i këtij zhvillimi dëshmohet nga themelimi i qyteteve të para ilire në fund të shek. V p.e.s. ku ndër pionierët e parë të qytetërimit ilir ishte Nikaja. Qyteti i Nikajës u themelua mbi një kodër pranë fshatit Klos. Zgjedhja e pozicionit

lidhej jo vetëm me mundësinë e mbrojtjes por edhe me faktorë të tjerë. Qyteti u themelua pranë lumit Aoos (Vjosa) lugina e të cilit i mundësonte lidhjen me fushën e Cakranit dhe në vazhdim me luginën e Kallmetit. Qyteti antik të Apolonisë pasi në antikitet lumi Vjosë rridhte pranë Apolonisë.



- **Muri rrethues** me dy faza, faza e parë, fundi shek. V p.e.s. dhe faza e dytë shek. IV-III e.s. Gjatësia 1850m, lartësia 8-9m, gjerësia 3-3,5m, ruhet në gjendje të mirë;
- **Teatri**, shek.III p.e.s. kapaciteti 800-1.000 spektatorë, 15 shkallë, ruhet në gjendje të mirë;
- **Stoa**, sipërfaqja 400m², ruhen vetëm themelet;
- **Banesa**, ruhen dy banesa të thjeshta me sipërfaqe rreth 300m² secila.




Figura 2 - Shpërndarja e monumenteve historike në territorin e bashkisë



Figura 4 - Qyteti antik i Nikajas, Kloss



○ *Pyjet e zonat e mbrojtura natyrore*

Në territorin e bashkisë Mallakastër ndodhen 15 monumente natyre, të shpallura me VKM Nr.676, datë 20.12.2002 të listuar si më poshtë:

Biomonumente

1. **Lisat e Cfirit**, ndodhen në fshatin Cfir, në një lartësi prej 447 m mbi nivelin e detit. Janë 4 lisa afër njëri- tjetrit në një kodrinë që ka shërbyer si varrezë e fshatit por njëri është më i vjetër se të tjerët dhe ka lartësi 6 m dhe diametër të trungut 110 cm, është një dru shumë i mocëm 320 vjeçar kurora e tij është shumë e bukur në formën e një ombrelle. Vlerat e këtyre lisave janë shkencore, biologjike, ekologjike, turistike. Për t'a vizituar këtë monument natyre rruga nis nga qyteti i Ballshit – K.P.TH.N-ja – Aranitas- Cfir.
2. **Rrapi i Ballshit**, ndodhet në qendër të qytetit Ballsh në lartësinë 200 m mbi nivelin e detit. Është një dru me lartësi 14 m, diametër 80 cm, moshë 70 vjeçare, me formë të veçantë (ombrellë) dhe kurorë shumë të madhe. Ka vlera shkencore (biologjike), didaktike, edukuese.
3. **Lisi i Ngracanit**, ndodhet në Ngraçan, lartësia 9m, diametri trungut 50 cm , mosha 150 vjeçar. Është pranë skarpatës së rrugës dhe nën kurorën e tij gjendet një vend i shenjtë , ku banorët kanë ndërtuar një mekam të vogël dhe ndezin qirinjë. Ky biomonument ka vlera shkencore, biologjike, ekologjike por edhe mësimore.
4. **Lisi i Lapulecit**, vendndodhja Lapulec, 350 m mbi nivelin e detit, lartësia 12 m, diametri trungut 0,86 m, mosha 310 vjeçar.
5. **Lisat e Kalenjës**, vendndodhja Kalenjë, 200 m mbi nivelin e detit, lartësia mesatare 12-15m, diametri trungut 0,90 m, mosha mbi 150 vjet.
6. **Rrapi i Vodicës** (Rrapi i ujit), vendndodhja Drizar, lartësia 20 m, diametri i trungut 2,3m, mosha mbi 400 vjeçar.
7. **Lisi i Çerrilës** (Lisi i Vakëfit), vendndodhja Çerrile, 670 m mbi nivelin e detit, lartësia 21m, diametri i trungut 0,84m, mosha 450 vjeçar, largësia nga qyteti Ballsh 35 km. Njihet edhe me emrat Lisi i Vakëfit ose Lisi i Njomë. Ka një formë shumë të vecantë kurore (ombrelle) dhe shumë të madhe. Në mbrojtjen e tij ka ndikuar dhe prania aty afër e Varrit të Gjurmës së Shenjtë në shkëmbin ranorë, në pjesën veriore të kodrës, prej këtej ka ardhur edhe emërtimi “ Lisi i Vakëfit”. Territori përreth ka qenë shumë i pasur me pyll dushku, tashmë është një dushkajë e degraduar, por ka dhe shumë shkurre tipike mesdhetare si koçimare, cëmërdel etj. Gjithashtu përreth tij ka dhe ripyllëzime me pishë e bërë në vitet 60 të shekullit të kaluar. Rritja e drurëve të mbjellë është e mirë dhe nuk ka dëmtime. Ky monument ka vlera shkencore (biologjike) ekologjike, fetare, mësimore, dhe edukuese me rëndësi lokale.
8. **Rrepet e Vurgut të Çorrushit**, vendodhja fshati Çorrush, në lartësinë 200 m mbi nivelin e detit. Përbën një grup drurësh me lartësi 12-15 m, diametër rreth 80 cm dhe moshë 200-250 vjeçarë, me formë të veçantë në të djathtë të luginës së Vjosës, në rrëzën e kodrave të fshatit Çorrush dhe shtëpive të tij. Pranë tyre dalin burime uji dhe ka edhe bimësi, gjë e cila e bënë edhe më tërheqës mjedisin.



9. **Rrepet e Festës (Rrepët e Poçemit)**, ndodhen pranë burimeve të fshatit Poçem. Janë grup drurësh, të cilët së bashku me vërritë, shëlgjet, plepat, akacjet, etj., kanë formuar një pyll prej më shumë se 35 vjetësh. Lartësia e rrepeve të shpallur monument natyre është rreth 15 m, ndërsa gjerësia e trungut është 1,5 – 2,5 m. Pjesa më e madhe e tyre janë në të dy krahët e kanalit kryesor të burimeve të Poçemit, ujërat e të cilit janë përdorur deri 20 vjet më parë nga mulliri i Kashtës. Këto rrepe kanë vlerë biologjike, estetike, por edhe historike. Këtu është mbledhur dy herë populli i Mallakastrës dhe është betuar për të vazhduar luftën kundër pushtuesit italian në vitin 1920 dhe kundër pushtuesve nazifashiste në vitet '40 të shekullit të kaluar. Këtë të fundit e përkujton lapidari i ngritur pranë këtyre rrepeve madhështor. Në muajin Korrik të çdo viti, këtu mbledhet populli i Mallakastrës për të përkujtuar ngjarjen e madhe të historisë së tij. Kjo shpesh quhet edhe “Besë e Poçemit”, dhe rrepet kanë marrë edhe një emër të ri, Rrepet e Festës së Poçemit. Peizazhi përreth është shumë tërheqës në çdo stinë. Vizitohet sipas intinerarit të rrugës kombëtare Ballsh – Poçem.⁴

10. **Lisat e Lavdanit** - ndodhen në fshatin Lavdan i cili është vendosur pak km në lindje të qytetit të Ballshit dhe vetëm 1 km larg nga K.P.Th.N.-ja. Ky monument natyre ndodhet në pjesën veriore të kodrinës ku është vendosur fshati i Lavdanit. Këtu ajo ka lartësinë 283 m mbi nivelin e detit. Ai gjendet në një kodrinë që shërben si varrezë e fshatit. Është dru i vetëm i ruajtur në një territor të gjerë përreth tij. Ky Lis ka një lartësi prej 20 m dhe kurorë në formë ombrelle mjaft e dëmtuar nga shkarkimet atmosferike (rrufetë). Degët kryesore janë prerë dhe trungu kryesor me diametër mbi 90 cm moshë mbi 150 vjet.

11. **Arra e Hekalit** – Monumenti nuk ekziston më.

Gjeomonumente

12. **Mospërputhja e Greshicës**, ndodhet pranë fshatit Greshicë. Ka një gjatësi prej rreth 100m, dhe lartësi lartësia 4-5m. Monumenti i përket epokës së Oligocenit

13. **Shpella e Lakuriqit (Shpella e Kremenarit)**, ndodhet në fshatin Kremenar, Njësia Administrative Fratar. Ka një thellësi prej 80 m, gjerësia 10 m dhe lartësi 8-10 m. Monumenti ndodhet 250m mbi nivelin e detit.

14. **Burimet termale të Povelës**, ndodhen pranë fshatit Povël. Kanë një sipërfaqje prej 6 m², prurje 100-150 litra/orë dhe temperaturë uji 14-16°. Ndodhen në veri të fshatit Symizë, në të majtë të rrugës automobilistike Ballsh – Fratar. Monumenti përbëhet nga 2-3 burime të vegjël, të cilët dalin në rrëzën e shpatit jugor të një kodrine të formuar në shkëmbinjtë gëlqeror. Uji i tyre del 40-50 cm mbi shtratin e përroit të Povelës. Para se të bashkohen me ujin e këtij përroi ato formojnë një tip ligatine 5-6 m² me bimësi të xunkthit, etj. Bimësia e shëlgut është prerë nga banorët, ndaj shfaqet në formën e shkurreve, ndërsa ajo sipër burimit është përfaqësuar më shumë nga përralli e cila është degraduar nga prerjet pa kriter.

⁴ Burimi: www.akzm.gov.al





Figura 3 - Harta e shpërndarjes së monumenteve të natyrës

Vizioni i PPK-së për sistemin natyror shprehet nëpërmjet dy koncepteve: Promovim dhe Akses. Në këtë kuadër, zgjidhjet, që propozon PPK-ja, janë:

- Rritje të zonave natyrore nëpërmjet shtimit të zonave të mbrojtura dhe korridoreve lidhëse natyrore përgjatë luginave të lumenjve.
- Shtimi i 3 (tre) parqeve kombëtare në rrjetin kombëtar të zonave të mbrojtura, ndër ta edhe parku i Vjosës.




○ Zonat me rrezik natyror⁵

Kryesisht zona vitet e fundit ka patur një rrezikshmëri të lartë natyrore të shfaqur në forma të rrëshqitjes, shkarje, etj, në fshatin Ngracë, Fshatin Kash, Njësia Administrative Qendër Dukas; në fshatin Hekal, Njësia Administrative Hekal; në Fratar, Njësia Administrative Fratar në fshatin Kutë Njësia Administrative Kutë, në fshatin Aranitas Njësia Administrative Aranitas, në fshatin Gjerbës Njësia Administrative Selitë etj. Pas kërkesave të banorëve në lidhje me këto problematika Bashkia Mallakastër i është drejtuar me shkresë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar. Nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar janë realizuar studimet gjeologo – inxhinierike për zonat në të cilat ka pasur rrëshqitje.

Regjimi tektonik në shtypje, i cili vihet re në Mallakastër, ka krijuar struktura të rudhosura si, antiklinale dhe sinklinale. Lëvizjet tektonike me moshë të re, të cilat vazhdojnë edhe në ditët e sotme, tentojnë t'i ndërlikojnë gjithmonë e më shumë strukturat e rudhosura dhe për pasojë relievin. Ato, nga njëra anë tregojnë se trualli i Mallakastrës nuk është i stabilizuar, nga ana tjetër tregojnë se territori i kësaj zone mund të përfshihet vazhdimisht nga lëvizje sizmike. Lokalizimi

⁵ Burimi: Harta Gjeologjike e Shqipërisë me shkallë 1: 200.000

i këtyre thyerjeve tektonike, gjatësore dhe tërthore e ndihmon shoqërinë njerëzore të kufizojë aktivitetin e saj në këto territore që konsiderohen si më të kërcënuara nga tërmetet, proceset e shpatit, deformimet e mëtejshme të relievit, etj.



Erozioni, fenomenet e shpatit, karsti, etj, do të intensifikohen më tej, nëse nuk frenohet dëmtimi i bimësisë. Përmasat e frikshme të erozionit përgjatë luginës së Vjosës (ku qindra hektar janë gërryer, apo kthyer në toka të pashfrytëzueshme si rezultat i përmbytjeve, devijimit të shtratit të lumit), si dhe në mjaft toka në shpatet kodrinore me pjerrësi të madhe, po shtron nevojën e ndërhyrjes së menjëhershme në territoret e rrezikuara të Mallakastërës.


○ *Rrjetet ekologjike*

Fauna e Mallakastërës ka pësuar ndryshime, nga ndërhyrja gjithmonë e në rritje e shoqërisë njerëzore. Kjo si rezultat i shpyllëzimeve, hapjes së tokave të reja, prerja dhe dëmtimi i bimësisë, dëmtimi i habitateve dhe ekosistemeve, etj.

Përsa i përket faunës ujore, me rëndësi ekonomike janë peshqit, të cilët jetojnë në ujërat e lumenjve, përrrenjtë e mëdhenj, si dhe tek liqenet artificiale. Kështu në lumin e Vjosës, në rrjedhën e sipërme të Gjanicës, gjendet mlyshi (lauciscus), mustaku (Barburs), ndërsa tek ujëmbledhësit gjenden peshqit ballgjerë, amur, pëllëmbës, karas, etj.

Nga fauna e shpendëve që lidhen me ujërat, janë kryesisht rosat si, rosa e vendit (Anas Platyrhynchus), rosa e vogël (Anas Crecca), bishtgjela (Anas acuta) dhe patat si, ajo Ballbardhë (Auser albifront) dhe më rrallë pata e madhe (Anas ausers), dhe pata belba (Anas fabalis).

Këto shpendë takohen sidomos në muajt e ftohtë, të cilat janë objekt gjuetie. Në këtë zonë ndodhen edhe një numër i madh shpendësh të zakonshëm, dëmtues si, sorrat (corvux cornix), laraskat (Pic pica), stërgoka ose gala (calculus monedula), harabelat (passer). Nga llojet e shpendëve të tjerë janë, turtulli (sterptopelia turtur), shkurta (coturnix coturnix), etj. Në lindje të



Mallakastrës, në pyjet e dushkut, takohen pëllumba të egër (Columba) dhe guarku (Columba palumbas). Ndërsa, në territoret gëlqerore sigjendet thëllëza e malit (Alectoris graeca). Në sipatet e kodrave dhe luginat e përrrenjëve të veshura me shkurre dhe drurë me gjethe, gjatë gjithë vitit gjejnë strehë gjitarët si, ujku (canis lupus), dhelpra (vulpes vulpes), çakalli (canis aureus), lundërza (lutra lutra), dhe pranë ujërave të lumenjve, baldosa (Meles meles), lepuri (Lepus europaeus) dhe gjitarë thundrorë si, derri i egër (sus acrofa).

Nëse do të bëjmë një vlerësim të florës dhe faunës që gjendet në Mallakastër, arrijmë në këto përfundime kryesore:

Flora dhe fauna e Mallakastrës, megjithëse përbëhet nga një numër i madh llojesh dhe nënllojesh, mund të themi se ajo është e varfër në raport me kushtet mjedisore që ekzistojnë aty. Kjo lidhet me faktin se shoqëria njerëzore ka vepruar me agresivitet të madh ndaj bimësisë, nëpërmjet shpyllëzimeve, djegies së pyjeve, mbikullotjes, hapjes së tokave të reja bujqësore, shfrytëzimit pa kriter të lëndës drusore, me anë të ndotjes, etj.

○ *Ekosistemet e rrezikuara dhe biodiversiteti*

Qendrat e banuara përgjatë luginës së Gjanicës, dëmtojnë seriozisht bimësinë dhe speciet ujore për shkak të niveleve të larata të ndotjes si rezultat i derdhjes në të i mbetjeve të naftës dhe nënprodukteve të saj nga Kombinati i Përpunimit të Thellë të Naftës në Ballsh. Veç kësaj fauna ujore është e kërcënuar edhe në lumin Vjosë si pasojë e ndërhyrjeve pa kriter në shtratin e tij për nxjerrjen e inerteve dhe materialeve të ndryshme si zhavorri apo rëra.

Por vitet e fundit është shfaqur dhe një problem serioz për ekzistencën e florës dhe faunës pasi po ndërhyhet pa kriter në hapjen e tokave të reja nëpër kodra duke e zhveshur atë nga bimësia dhe speciet e gjalla që popullojnë këto kodra.

○ *Burimet minerare e natyrore dhe rrjetet*

Në këtë kategori bëjnë pjesë burimet e naftës. Në territorin e Bashkisë Mallakastrës ka vendburime të naftës në këto Njësi Administrative: Njësia administrative Hekal, Njësia administrative Qendër, Ballsh. Në territorin e bashkisë Mallakastër gjenden këto vendburime të karbonatit :

Vendburimi Cakran – Mollaj

Ky vendburim është një rezervuar gëlqeror karbonatik me presione mbi normale. Është zbuluar në fund të viteve '70 dhe shfrytëzohet me puse vertikale mjaft të thellë, të cilët arrijnë deri në 3,800 m thellësi totale. Gjithsej janë 81 puse në inventarin e këtij sektori, ndër të cilët maksimumi 32 numërohen si tradicionalë aktive. Pjesa tjetër e puseve kërkojnë remonte dhe investime serioze për t'u kthyer në pune. Nafta e këtij vendburimi krahasuar me atë të vendburimeve të tjera në Shqipëri klasifikohet si e lehtë me një peshë specifike prej rreth 0.9 gr/cm³.

Vendburimi Ballsh – Hekal

Vendburimi Ballsh – Hekal është i tipit gëlqeror karbonatik me regjim ujërash fundore dhe kapele gazore. Një pjesë e vogël e vendburimit i është lënë me koncesion një kompanie private, e cila administron gjithsej rreth 26 puse, ndër të cilat 14 prej tyre aktive. Në administrimin e Albpetrol janë

206 puse në inventar, ndër të cilët rreth 100 puse janë aktivë. Nafta e këtij vendburimi është relativisht e rëndë me një peshë specifike prej 0.97 gr/cm³.



Vendburimi i Visokës

Edhe në këtë vendburim ndodhen shumë puse të nxjerrjes së naftës nga të cilat në gjendje pune janë 29 të cilat administrohen nga kompani private .

Ballsh. Kompanitë që i shfrytëzojnë këto burime janë: ALBPETROL sh.a., Kombinati i Përpunimit të Thellë të Naftës, ARMO sh.a., STREAM OIL, SOG, ndërsa në burimet natyrore bën pjesë burimi i Poçemit që shfrytëzohet nga kompania FONTANA dhe KPTHN Ballsh.

Territori i bashkisë Mallakastër është i pasur gjithashtu me minerale si torfa, guri gëlqeror, rëra kuarcore, etj.

○ Komplekset e parqet industriale

Park apo kompleks industrial, zona në të cilat kryhet aktiviteti i mirëfilltë industrial në territorin e Mallakastrës mund të konsiderohet Kombinati i Përpunimit të Thellë të Naftës-KPTHN Ballsh. Ky kompleks industrial ndodhet në pjesën veriore të qytetit dhe zë një sipërfaqe rreth 1 km². Në brendësi të tij janë të pozicionuara një mori ndërtesash administrative, repartësh teknologjike dhe rezervuarësh të mëdhenj (kapaciteti më i madh i rezervuarve është 11000 m³), së bashku me linjat e dërgimit apo pjesë të tjera teknologjike në funksion të realizimit të proceseve të ndryshme teknologjike për përpunimin e naftës. Në brendësi të territorit të KPTHN-së Ballsh ndodhet edhe termocentrali i Ballshit i cili aktualisht prodhon vetëm avull teknologjik për proceset teknologjike që realizohen në KPTHN.

○ Rrugët kombëtare

Territorin e Bashkisë Mallakastër e përshkojnë këto rrugë nacionale :

Rruga nacionale SH4: Rr. Visok - Peçaj (Tepelenë), kategoria C;

Rruga nacionale SH100: Rr. Povël - Poçëm, kategoria C;

Rruga nacionale Rr. Levan - Damës (e reja) kategoria C.

Nëpërmjet PPV, bashkia Mallakastër do të propozojë:

- Të kryet lidhja me infrastrukturë rrugore e qytetit të Ballshit me Segmentin rrugor Levan-Tepelenë konkretisht nëpërmjet gjurmës Autostrada Levan – Tepelenë – Fshati Hekal dhe qyteti Ballsh.
- Të behet lidhja me autostradën Levan–Tepelenë me aksin që përshkron fshatrat Mollaj-Drenovë-Belishovë-Ofiçinë.

Gjithashtu, bashkia do të propozojë:

- Rikonstruksimin e segmentit nacional Ballsh- Fratar si rrugë nacionale në gjendje tejte të amortizuar;
- Zgjerimin e rrugës Qafa e Kashit – Bylis;
- Hapjen dhe ndërtimin e rrugës Aranitas – Metoh - Sinjë;
- Hapjen dhe ndërtimin e rrugës Bejar – Çorrush - Kutë;
- Hapjen dhe ndërtimin e rrugës Aranitas – Selitë – Kapaj;
- Hapjen dhe ndërtimin e rrugës Panahor - Ngraçan;

- Lidhjen me segmente rrugore të gjithë fshatrave të Bashkisë Mallakastë me qytetin e Ballshit.


○ Linjat hekurudhore dhe infrastruktura ndihmëse

Territori i Bashkisë Mallakastër përshkohet nga linja Hekurudhore Fier – Ballsh. Kjo linjë transporti udhëtarësh dhe mallrash shihet me interes për zhvillimin e zonës. Kjo linjë prej shumë kohësh është jashtë funksionit dhe ka nevojë për ndërhyrje totale që të kthehet në funksion të transportit hekurudhor.

- Poli i Zhvillimit Rajonal Vlorë – Fier – Berat

PPK parashikon ristrukturimin e sistemit hekurudhor për linjat kombëtare që lidhin bashkinë me infrastrukturën rajonale, ku përfshihet edhe segmenti Fier-Patos-Ballsh.

Duke ju referuar përsëri PPK në territorin e Bashkisë Mallakastër propozohet të ndërtohet pas vitit 2030 infrastruktura hekurudhore, e cila do të bëjë lidhjen me Greqinë duke ndjekur aksin Ballsh-Memaliaj-Gjirokastër-Janinë.⁶



Harta 5.6 Poli i zhvillimit rajonal Vlorë-Fier-Berat

○ Sektori i energjisë

Në territorin e Bashkisë Mallakastër nuk ka burime energjetike apo burime alternative për prodhimin e energjisë elektrike. Përsa i përket prodhimit të energjisë nëpërmjet erës shihet me interes nga ana e Bashkisë Mallakastër, por deri më sot nuk ka investime të tilla.

⁶ Burimi: Plani i Përgjithshëm Kombëtar _Sistemi Infrastrukturor_Transporti .Ministria e Zhvillimit Urban _AKPT - Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit .Sipas projekteve prioritare te Ministrise se Transportit dhe Infrastruktures, 2014.

Plani i Përgjithshëm Kombëtar parashikon kalimin në territorin e bashkisë Mallakastër dhe në qytetin e Ballshit të linjës së Gazsjellësit Adriatiko-Jonian si dhe ndërtimin e stacionit të matjes dhe reduktimit të presionit-PRMS Ballsh;

Linjat kryesore elektrike që përshkojnë territorin e Bashkisë Mallakastër janë:

- Linja Ballsh – Memaliaj, 110/2 Kilovolt;
- Linja Ballsh – Fier, 110 /1 Kilovolt;
- Linja Ballsh – Drenovë – Selenicë, 110 Kilovolt;
- Linja Ballsh – Poçem, 35 Kilovolt;
- Linja Ballsh – Patos, 35 Kilovolt.

Termocentrali i Ballshit aktualisht nuk është aktiv, pasi punon vetëm për prodhimin e avullit teknologjik në funksion të KPTHN-së, pra nuk prodhon energji. Përmes implantit teknologjik i zbutjes së ujit realizohet pastrimi dhe zbutja e ujit për furnizimin e kaldajave për prodhimin e avullit.



Në territorin e Mallakastrës ndodhen edhe disa burime natyrore termale të Povlës, vendndodhja fshati Kapaj, përshkruar më sipër.

- *Hidrocentralet në territorin e Bashkisë Mallakastër*

Në territorin e Bashkisë Mallakastër nuk ka aktualisht të ndërtuar hidrocentral publik ose privat. Megjithatë, në vitin 2016 qeveria shqiptare ka dhënë me koncesion ndërtimin e hidrocentralit të Poçemit, mbi lumin Vjosa. Ky hidrocentral pritet të prodhojë 305 mln kWh energji në vit.

- *Instalimet e infrastrukturës kombëtare, infrastruktura e komunikimit elektronik:*

Territori i Bashkisë Mallakastër përshkohet nga rrjeti i fibrave optikë që shtrihet në aksin Fier–Ballsh, Tepelenë–Ballsh.

- *Zhvillimet në zonat ushtarake⁷*

Në Bashkinë Mallakastër, objekte që janë në pronësi të Ministrisë së Mbrojtjes janë ndërtesat e reparteve ushtarake të ndodhura në këto zona :

⁷ Burimi i informacionit: VKM Nr.515 datë 18.07.2003 “Për inventarizimin e pasurive të pajuareshme në zonat ushtarake”

Reperti Nr. 9445

Reperti në qytetin Ballsh

Reperti në Hekal

Reperti në Fratar

Reperti në Greshicë

Depo të ndodhura në këto zona :

Fshatin Visokë

Fshatin Aranitas

A.K.A.

Ballsh

Kalenjë

Panahor

Reperti Nr. 4625

Reperti Ballsh

Reperti Dukas

Reperti Kalenjë

Reperti Kutë

Reperti Fratar

Ish-tunelet, të cilat ndodhen pothuajse në çdo shesh dhe bllok lagjeje në qytet. Nga të dhënat dhe informacionet që disponon Bashkia Mallakastër, një pjesë e këtyre ish-godinave ushtarake janë privatizuar.

○ Burimet ujore, lagunat, lumenjtë, liqene

Hidrografia e Mallakastrës karakterizohet nga pasuri e ujërave sipërfaqësore dhe varfëri në rezervat e ujërave nëntokësorë. Një tregues i tillë është kushtëzuar nga përbërja gjeologjike, litologjia, klima, faktori topografik, etj. Ujërat sipërfaqësorë këto përfaqësohen nga një sërë rrjedhjesh ujore, basenesh dhe burime të ndryshme, të cilat janë të shpërndarë në mënyrë jo uniforme në Mallakastër.

Lumenjt⁸

Pellgu	Lumi	Degët kryesore	Gjatësia në km	Degët dytësore	Gjatësia në km
	Gjanicës	Prr Lumarës	15.4	Prr Rehovës	3.4
				Prr Hasanit	3.8
				Prr Çërrilës	4.5
				Prr Velçanit	7
				Prr Levanit	3.2
		Prr Shpellas	2.7	=====	=====
		Prr Kalenjës	3.2	=====	=====
		Prr.Mezhdës	3.9	=====	=====
		Prr Gones	3.2	=====	=====
		Prr Madh	2.8	=====	=====
		Prr.Belishovës	2.7	=====	=====
		Prr Prallit	4	=====	=====
		Prr Gremës	3	=====	=====
		Prr. Gjorgozit	3.3	=====	=====
		Prr Patosit Fshat	2.6	=====	=====

Tabela 12- Rrjedhjet ujore të pellgut të Semanit që kalojnë në territorin e Mallakastrës⁸

⁸ Burimi i informacionit: (Kristo. V, Veçoritë fiziko gjeografike të zonës kodrinore midis Vjosës dhe Osum-Semanit fq. 52, viti 1980)



Mallakastra dallohet për një rrjet të dendur lumenjsh, përrrenjsh dhe rrëkesh. Shpërndarja e tyre jouniforme është kushtëzuar nga ndërtimi gjeologjik, ku dendësi më të madhe kanë ujë sipërfaqësorë tek shkëmbinjtë terrigjenë. Për dendësi të madhe të rrjetit hidrografik, dallohen territoret në rrjedhën e sipërme të Gjanicës, ndërsa përreth Shpiragut vihet re e kundërta. Edhe relievi ka pasur një rol të rëndësishëm në rrjedhjet sipërfaqësore që kalojnë në territorin e Mallakastrës, të cilat karakterizohen nga gjatësi e vogël dhe pellgjet ujëmbledhës me sipërfaqe jo të mëdha. Sipas përmasave dhe prurjes së lëngët, lumenjtë e kësaj zone janë të vegjël. Shumica e rrjedhjeve ujore janë të përkohshme. Vartësia e tyre e drejtpërdrejtë nga reshjet dhe shumë pak nga ujërat nëntokësorë, ka bërë të mundur që përrrenjtë të kenë ujë gjatë periudhës së lagësht të vitit, ku vihen re edhe plotat, ndërsa gjatë stinës së verës ato kanë prurje minimale, për të mos thënë që thahen fare. Përrjashtim bën Vjosa, ku ujërat nëntokësorë mbajnë një peshë të rëndësishme në prurjet e lëngta të saj. Në mjediset karstike të Mallakastrës, prezenca e ujërave sipërfaqësore është tepër e pakët dhe kohëzgjatja e tyre varion në disa orë ose ditë (në vartësi të reshjeve), duke krijuar deficite të mëdha hidrike. Duhet theksuar se prurjet e rrjedhjeve ujore në Mallakastër janë të paparashikueshme, pasi sasia e reshjeve dhe intensiteti i tyre është i tillë (karakteristikë e klimës mesdhetare). Kështu përrrenjtë në momente të caktuara duken si lumenj të vërtetë, duke sjellë sasi të mëdha të prurjeve të ngurta dhe të lëngëta, gjithashtu dallohen për një aktivitet të fuqishëm eroziv, ndërsa kur nuk kanë ujë duken si shtretër të thatë të dikurshëm. Këto kontraste kaq të mëdha krijojnë rreziqe natyrore (gjatë periudhës së reshjeve) si, rrëshqitjet, rrëzimet, erozioni, dëmtimi i tokave, përmbytje, etj, duke lënë pasojë në mjedis dhe aktivitetin human. Lumenjtë kryesorë që kalojnë në territorin e kësaj zone janë: Vjosa, Gjanica, Povla, ndërsa të tjerët janë të vegjël dhe përfshihen në grupin e përrrenjve.

Lumi i Gjanicës, me një sipërfaqe prej 234,1 km², ka një formë të përzgjedhur nga JL-VP. Koeficienti i zgjatjes është 6,7. Prurja e lëngët shkon deri 2,99 m³/ sek. Lumi i Gjanicës në territorin e Mallakastrës shtrihet pjesërisht me një gjatësi 52.4 km, nga 66.7 km që është gjatësia totale e tij. Lartësia mesatare e pellgut është 365 m. Gjanica, si lumë, fillon të njihet me këtë emër menjëherë pas bashkimit të Lumarës (e cila buron në veri të kodrave të Allkomemaj në lartësinë 800 m) dhe përroit të Metohut në gropën e Aranitasit. Në rrjedhën e mesme asaj i bashkohen një sërë përrrenjesh si, ai i Lapulecit, Ngraçijes, Gjinoqarës, etj. Prurjet më të mëdha vihen re në periudhën Nëntor-Maj, pra në sezonin e rreshjeve. Raporti midis prurjeve më të mëdha dhe më të ulëta është 9:1. Karakteristikë tjetër është rritja e menjëhershme e prurjeve. Brenda ditës prurjet maksimale për Gjanicën kanë qenë 392 m³/sek (dt 10/11/1969). Moduli mesatar i rrjedhjes së saj është 9.18 l/sek për km², kurse vlerat më të vogla 9,13 l/sek/ km². Arsyeja, që moduli i saj është më i vogël, lidhet me faktin se ushqimi nga ujërat nëntokësorë është i vogël dhe kushtet gjeologjike nuk janë të përshtatshme për grumbullimin e ujërave nëntokësore. Ky lumë dallohet për ndotjen më të rëndë në Shqipëri, ku çdo muaj derdhen rreth 12.587–18.091m³ mbeturina të lëngëshme me përmbajtje hidrokarburesh dhe vajrash industriale. Kjo ndotje shkakton probleme ekologjike tepër të mëdha, përgjatë luginës së saj, në rrjedhën e poshtme të lumit Sëman dhe në bregdet. Pasojë e ndotjes është dëmtimi i florës dhe faunës, ndotja e tokave, bregdetit, etj. Ndotja në vlera tepër të larta të këtij lumi, përbën një rrezik serioz për popullsinë që jeton dhe ushtron aktivitetin e saj në këto vise.

Lumi i Powlës, është degë e lumit të Vjosës. Si fillim i saj merret përroi i Zi, i cili buron në anën perëndimore të kodrave të Allkomemaj. Pas bashkimit të tij me përroin e Konjakut dhe Lladovës, fillon dhe merr emrin lumi i Powlës me gjatësi 19,5 km, pjerrësi gjatësore 0,325 m/km dhe koeficient të zgjatjes 3,5. Degë kryesore të Powlës janë edhe Vashnica, Marusha, Gurza, përroi i Thatë, etj. (Tab

13) Lartësia mesatare e pellgut ujëmbledhës është 353 m. Kjo tregon se territori ku kalon ky lumë përbëhet kryesisht nga kodrat, të cilat shkojnë nga 300-700 m. Në rrjedhën e sipërme dhe të mesme Povla kalon në depozitime terrigjene, ndërsa në rrjedhën e poshtme ajo kalon në formacione gëlqerore. Prania e gëlqerorëve krijon mundësi që ky lumë të ushqehet nga ujëra nëntokësore, kur rreshjet pakësohen ose mungojnë. Prurja mesatare e lumit të Povlës është 2,4 m³/sek. Prurjet më të mëdha vihen re në periudhën e ftohtë të vitit, ku rreshjet janë më të mëdha. Moduli i rrjedhjes së Povlës është 22 l/sek/km², ndërsa prurjet aluvionale 9, 36 kg/sek ose 2700 ton/km²/vit.

Pellgu	Lumi	Degët kryesore	Gjatësia në km	Degët dytësore	Gjatësia në km	Degët tretësore	Gjatësia në km
		Prr Krahësit *	3.85	Prr Kobileshtit	1.82	=====	=====
		Prr i Madh	9.87	=====	=====	=====	=====
		Prr Kutës	8,4	Prr i Bardhës	1.93	=====	=====
				Prr Shizka	2.6	=====	=====
		Prr Kaçelit	3.5	=====	=====	=====	=====
		Prr Çorrushit	4.12	=====	=====	=====	=====

Tabela 13- Rrjedhjet ujore të pellgut të Vjosës që kalojnë në territorin e Mallakastrës

Lumi i Vjosës është lumi më i madh i Shqipërisë Jugore, me gjatësi 272 km dhe pellg ujëmbledhës 6.710 km². Ai shtrihet në skajin Jugperëndimor të bashkisë dhe përben kufirin midis bashkisë Mallakastrë dhe Bashkisë Selenicë. Sektori nga Kalivaçi në Poçëm është pjesë e rrjedhës së mesme, ndërsa nga Poçëmi në Kashisht i asaj të poshtme. Në rrjedhën e mesme, Vjosa karakterizohet nga zgjerimi i luginës në 1-2 km si, në Kutë, Poçëm por edhe nga ngushtime të menjëhershme. Në rrjedhën e poshtme, Vjosa ka një shtrat të gjerë. Morfologjia e shtrati përbëhet nga dy elemente:

- nga shtrati i vjetër dhe i gjerë,
- nga tarraca e re, e cila në shumë raste është e mbuluar nga argjila, duke formuar fusha të tëra. Lumi meandron mbi sedimentet e shtratit të vjetër, duke formuar sedimentet e sotme. Në gjeomorfologjinë e shtratit kanë ndikuar përrrenjtë e shumtë si, Povla, Hekali, Gorishova, Kreshpani, Kalinora përroi i Turbullt në krahun e djathtë të lumit.

Vjosa është një lumë tipik mesdhetar, me regjim tepër të çrregullt, me oshilacione të mëdha të prurjeve të lëngëta dhe të ngurta gjatë stinëve të vitit. Duhet theksuar, se ushqimin kryesor për Vjosën e përbëjnë ujërat sipërfaqësore, me rreth 69%, ndërsa ato nëntokësore rreth 31%. Ky raport shpjegon mjaft qartë ecurinë e prurjeve të lëngëta gjatë vitit, të cilat varen kryesisht nga regjimi i rreshjeve dhe sasia e tyre, gjithashtu na jep informacion për aktivitetin e lumit, i cili paraqitet me kontraste të mëdha. Prurja mesatare e lëngët e Vjosës, në Poçëm është 171 m³/sek dhe ajo minimale 41.4 m³/s. Vjosa ushqehet kryesisht nga rreshjet e shiut dhe më pak nga ato të dëborës, të cilat janë përqëndruar gjatë periudhës së ftohtë të vitit. Sasia mesatare e rreshjeve, në sektorin nga Dorza në Mifol, luhet nga 1390-1340 mm.

Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon marrjen në mbrojtje të pellgut ujëmbledhës të Vjosës. Vjosa dallon nga të gjithë lumenjtë e tjerë në Ballkan për shkallën e lartë të ujëshmërisë, ndërtimin gjeologjik të formacioneve që përshkon dhe larminë e peizazheve përgjatë luginës. Mbrojtja do të realizohet duke aplikuar procesin e menaxhimit të integruar të burimeve ujore, me synimin që të përcaktohen zonat ekologjike për t'u shpallur në mbrojtje, duke ndjekur në mënyrë të harmonishme, parimet e mëposhtme:

- Barazi Sociale: që të sigurohet qasje e barabartë për të gjithë përdoruesit (veçanërisht grupet e

margjinalizuara dhe përdoruesit e varfër) për një sasi dhe cilësi të nevojshme të ujit, për të plotësuar nevojat dhe mirëqenien e tyre.⁹



Ujërat nëntokësore

Mbi gjendjen dhe përhapjen e ujërave nëntokësore, jemi bazuar në të dhënat e burimeve natyrale dhe puseve të hapura nga banorët e kësaj zone. Përhapja e gjerë e depozitimeve terrigjene dhe grada e tyre ujëmbajtëse shumë e dobët, nuk ka favorizuar grumbullimin e ujërave nëntokësorë. Kjo gjë reflektohet qartë në numrin e burimeve natyrale dhe në prurjet e pakta të tyre, mesatarisht 0,01 l/sek deri në 0,1 l/sek. Kushte më të përshtatshme, për grumbullimin e ujërave nëntokësorë, ekzistojnë kryesisht tek konglomeratët, ranorët dhe depozitimet konglomerato-ranore. Në këta shkëmbinj vihet re dalja e ujërave nëntokësore në formë burimesh natyrale ose puse të hapura nga fshatarët. Pasqyra e ujërave nëntokësore, ose niveli statik i ujit të puseve, lëviz nga 8-8,5 m në kodrat e Krapsit, 9-11 m në kodrat e Allambresit, 12-13 m në ato të Lapulecit. Regjimi i burimeve dhe i puseve është i paqëndrueshëm, me luhatje të mëdha gjatë stinëve të vitit, por edhe nga njëri vit në tjetrin. Ato kanë më shumë ujë në stinën e dimrit dhe më pak në stinën e verës, çka tregon varësinë e tyre të drejtpërdrejtë nga reshjet. Ujërat nëntokësorë, grumbullohen edhe atje ku haset gërshetimi i shkëmbinjve gëlqerorë me terrigjenët. Kur shtresat e shkëmbinjve me përshkueshmëri të ndryshme dalin në sipërfaqe, krijohen kushte për formimin e burimeve karstike. Disa prej këtyre burimeve janë dhe *Burimet e Poçemit*.

Këto burime bëjnë pjesë në grupin e ujërave karbonat-kalciumi-magnezi. Ato dalin në të majtë të lumit të Powlës, në sektorin ku Povla bashkohet me Vjosën, e cila sapo ka kaluar grykën e Kremenarës. Kuota e daljes së burimeve është 45 m mbi nivelin e detit. Këtu takohen 8 burime, me dalje në një front 400 m të gjatë. Burimi më i madh është burimi i Mullirit të Kashtës, me prurje 550 l/sek dhe të gjithë së bashku 700 l/sek. Prurja e burimeve karakterizohet nga rregjim i qëndrueshëm (prurja minimale 695 l/sek, prurja maksimale 970 l/sek dhe ajo mesatare 840 l/sek). Fakti që burimet e Poçemit kanë prurje të madhe në një territor karstik me sipërfaqe të vogël (në strukturën e Kremenarës 34km²), shpjegohet me zhvillimin intensiv të karstit, ku një rol të rëndësishëm luan edhe shkalla e lartë e çarshmërisë së shkëmbinjëve. Temperatura e burimeve është 14-15°C. Burimi i Poçemit furnizon me ujë Uzinën e Përpunimit të thellë të Naftës-Ballsh. Një pjesë e këtyre ujërave karstike përdoren si ujëra të pijshme. Ato, pasi përpunohen, i destinohen tregut vendas dhe të huaj.

Nëse do të trajtojmë shpërndarjen e ujërave nëntokësore sipas kriterit litologo-stratigrafik, në Mallakastër, dallojmë këto komplekse ujëmbajtëse:

Liqenet artificiale

Në territorin e Bashkisë Mallakastër janë ndërtuar edhe disa ujëmbledhës artificiale, të cilët janë destinuar për ujitjen e tokave bujqësore. Këto liqene artificiale janë krijuar kryesisht në territoret kodrinore të Mallakastrës, duke grumbulluar ujërat gjatë periudhës së lagësht të vitit. Megjithëse kapaciteti ujëmbajtës i tyre nuk është i madh, përsëri mund të themi se roli që ato kanë në ujitjen e tokave të Mallakastrës është i madh. Krahës vlerave ekonomike të tilla si, ujitje, peshkim, rekreacion, etj, këta ujëmbledhës kanë edhe vlera ekologjike. Pas ndryshimeve demokratike të viteve 1990, një

⁹ Burimi i inforacionit: Plani i Përgjithshëm Kombëtar, Shqipëria 2030

pjesë e konsiderueshme e tyre janë tharrë ose shkatërruar, duke zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme sipërfaqet bujqësore që ujitën. Ujëmbledhës të tjerë më të vegjël dhe dytësor nga rëndësia, janë rezervuari Lumara 1, rezervuari Lumara 2, rezervuari i Çuçenit, Bejarit, etj



Kanalet artificial

Pjesë e rjetit hidrografik, janë edhe sistemi i kanalizimeve që përdoren për ujitjen artificiale në Mallakastër. Nëpërmjet kanaleve, të cilët e kanë pikënisjen nga shtretërit e lumenjve Seman, Vjosë dhe një sërë përrenjësh që përshkojnë territorin e Mallakastrës, devijohet një pjesë e ujërave të tyre për ujitjen e sipërfaqeve bujqësore. Vetëm kanali Vjosë - Levan - Fier 32 km i gjatë, ka një kapacitet 15 m³/sek. Duhet theksuar se Vjosa ka qenë lumi që përdorej më shumë për ujitje disa dekada më parë, me një kapacitet që arrinte 50-60 m³/sek. Deri në vitet 1990-të nga ujërat e lumit Vjosa ujiteshin rreth 40.000 ha tokë bujqësore.

Emri i liqenit	Sipërfaqja në ha	Vëllimi i ujit në m3	Kapaciteti ujitës në ha
Lumara nr 1	45	4000	1500
Lumara nr2	30	3500	870

Tabela 14- Rezervuarët artificialë në Mallakastër

○ Tokat Bujqësore¹⁰

Ndarja e tokës sipas Kategorive⁷

Nj.A	Tokë Gjithsej Ha	Tokë Bujqësore Ha	Toka bujqësore				Kullota Ha	Pyje Ha	Truall Ha	Pa frut Ha	Toke Autostrad e Ha
			Are Ha	Pem Ha	Vreshta Ha	Ullinj Ha					
Ballsh	207.3	80	72	1	0	7	0	0	127.3	0	0
Qendër Dukas	7647.57	2751	1849	429	141	332	0	2125.1	71.47	2700	0
Selitë	4769.58	1092	693	280	41	78	71	2133	19.78	1454	0
Aranitas	5048.5	2173	1476	306	80	311	223	1560	35.5	1057	0
Fratar	6403.4	2052	1441	174	77	360	972.2	1625	49.5	1670	34.8
Hekal	5909.3	2525	1670	137	57	661	455	1762	39.75	1100	27.78
Greshicë	2278	944	641	134	26	143	519	73	15.7	726	0
Ngraçan	1747.93	488	320	124	4	40	0	399.18	9.13	851	0
Kuta	6104	2313.18	1484	282	43.8	504	902.13	1560	27.70	1300	0

Tabela 15- Tabela me ndarjen e tokave bujqësore sipas kategorive

Tabela 15- Tabela me ndarjen e tokave bujqësore sipas kategorive

¹⁰ Burimi i informacionit: Drejtoria e mjedisit dhe Bujqësisë në Bashkinë Mallakastër

Lista e ngastrave të lena jashtë kufijëve të Bashkisë Mallakastër					
që sipas VKM nr.433 datë 08.06.2016 pika 25 (nga numëri 1 deri tek numëri 83) janë pronë e Bashkisë Mallakastër.					
Nr.	Ekonomia	Ngastra nr.	Emërtimi Ngastrës	Sipërfaqja e ngastrës	Bashkisë që i ka kaluar Shënime
1	Çorush	3	Korie Qorrajt	20.5	Memaliaj
2	Çorush	4	Shullëri I Shehut	27.5	Memaliaj
3	Çorush	17	Mali I Dokes	15	Memaliaj
4	Çorush	18	M.dokes Korie.Shëngjergjit	53	Memaliaj
5	Çorush	19	M.dokes Korie.Shëngjergjit	20	Memaliaj
6	Çorush	25/b	Bostanet	11	Memaliaj
7	Çorush	25/c	Bostanet	8	Memaliaj
8	Çorush	26/a	Korie Xhelilit	47	Memaliaj
9	Çorush	26/b	Korie Xhelilit	2	Memaliaj
10	Gadurovë	23/a	Bardhaj	24	Memaliaj
11	Gadurovë	23/b	Bardhaj	9	Memaliaj
12	Gadurovë	24/a	Bardhaj Ara e Zonjës	18	Memaliaj
13	Gadurovë	24/b	Ara e Zonjës	10	Memaliaj
14	Gadurovë	25/a	Dushku I Bardhaj	17.5	Memaliaj
15	Gadurovë	25/b	Dushku I Bardhaj	22	Memaliaj
16	Gadurovë	26	Pishë Bari I butë	59.5	Memaliaj
17	Gadurovë	32	Pemiramaj Qafa Hopes	54	Memaliaj
18	Gadurovë	33	Pemiramaj Qafa Hopes	9.5	Memaliaj
19	Gadurovë	34/a	Lisi Xhafent	31	Memaliaj
20	Gadurovë	34/b	Lisi Xhafent	4	Memaliaj
21	Gadurovë	35	Shullëri I Çoçaj	33	Memaliaj
22	Gadurovë	36/a	Kuata 663	46.5	Memaliaj
23	Gadurovë	36/b	Kuata 663	3	Memaliaj
24	Gadurovë	37/d	Dushku I Kuq	10.5	Memaliaj
25	Gadurovë	37/b	Dushku I Kuq Mali koçiut	6.5	Memaliaj
26	Gadurovë	37/c	Dushku I Kuq Mali koçiut	15.5	Memaliaj
27	Gadurovë	37/d	Dushku I Kuq Mali koçiut	10.5	Memaliaj
28	Gadurovë	38	Proj I Zi	13	Memaliaj
29	Gadurovë	39	Proj I Zi	39	Memaliaj
30	Gadurovë	56/b	Proj Luadhit	27	Memaliaj
31	Gadurovë	56/c	Proj Luadhit	4	Memaliaj
32	Gadurovë	57	Shkëmbi Koçit	28.5	Memaliaj
33	Gadurovë	58	Kuata 650	22	Memaliaj
34	Gadurovë	59/a	Kuata 630	19	Memaliaj
35	Gadurovë	13/a	Kuata 630	0.5	Memaliaj
36	Lumarë	13/a	Hija e Çërnilës	31	Memaliaj
37	Lumarë	13/b	Hija e Çërnilës	0.5	Memaliaj
38	Lumarë	14/a	Hija e Çërnilës Mali Koxhelit	33	Memaliaj
38	Lumarë	14/a	Hija e Çërnilës Mali Koxhelit	33	Memaliaj
39	Lumarë	14/b	Hija e Çërnilës	0.5	Memaliaj
40	Lumarë	15/a	Hija e Çërnilës Mali Koxhelit	20	Memaliaj
41	Lumarë	15/b	Hija e Çërnilës	9.5	Memaliaj
42	Lumarë	15/c	Hija e Çërnilës	5	Memaliaj
43	Lumarë	16/a	Kuata 8811	27	Memaliaj
44	Lumarë	16/b	Kuata 8811	9	Memaliaj
45	Lumarë	2	Faqa e Malit Levan, Breg.Gjanicë	4	Berat
46	Lumarë	3	Faqa e Malit Levan, Breg.Gjanicë	5	Berat
47	Lumarë	5/a	Aranitas Rizaj, Mali Lumarit	18	Berat
48	Lumarë	5/b	Aranitas Rizaj,	13.5	Berat
49	Lumarë	11/a	Hija e Çërnilës	35	Berat
50	Lumarë	11/b	Hija e Çërnilës	4.5	Berat
51	Lumarë	11/c	Hija e Çërnilës	5.5	Berat
52	Lumarë	12/a	Hija e Çërnilës	24	Berat
53	Lumarë	12/b	Hija e Çërnilës	6	Berat
54	Cfir-Metoh	18	Metohu Malishaj	40	Berat
55	Cfir-Metoh	19/a	Metohu Malishaj	53	Berat
56	Cfir-Metoh	19b	Metohu Malishaj	3.5	Berat
57	Cfir-Metoh	19/c	Metohu Malishaj	8.5	Berat
58	Cfir-Metoh	20/a	Metohu Meçaj	28	Berat
59	Cfir-Metoh	20/b	Metohu Meçaj	7.5	Berat
60	Cfir-Metoh	21/a	Metohu Mustafaj	18	Berat
61	Cfir-Metoh	21/b	Metohu Mustafaj	7	Berat
62	Cfir-Metoh	23/a	Kumizi Proj Dragës	35	Berat
63	Cfir-Metoh	23/b	Kumizi Proj Dragës	8.5	Berat
64	Drenie	8/a	Muzga	38.5	Rroskovec
65	Drenie	8/b	Muzga	9.5	Rroskovec
66	Drenie	32/b	Çuka e Llasit	12.5	Patos
67	Kraps-Gjorgos	4/a	Shkurret e Kasnicës	40	Patos
68	Kraps-Gjorgos	4/b	Shkurret e Kasnicës	1	Patos
69	Kraps-Gjorgos	6	Belishovë Xhemaj	19	Patos
70	Peshtan-Cakran	27	Goras	27.5	Fier
71	Peshtan-Cakran	28/a	Goras	17	Fier
72	Peshtan-Cakran	28/b	Goras	12.2	Fier
73	Peshtan-Cakran	29/a	Goras	17.7	Fier
74	Peshtan-Cakran	29/b	Goras	6.8	Fier
75	Rromës	23	Korie Madhe	18.6	Fier Privat
76	Rromës	26/a	Bregu Koçiut	26.7	Fier Privat
77	Rromës	27/a	Bregu Koçiut	15	Fier Privat
78	Rromës	27/b	Bregu Koçiut	5	Fier Privat
79	Rromës	28/a	Bregu Koçiut	25.35	Fier Privat
80	Rromës	28/b	Bregu Koçiut	10.35	Fier Privat
81	Lumi Vjosa	5/a	Pylli Rromësit	10	Fier Privat
82	Lumi Vjosa	6/a	Pylli Rromësit	30	Fier Privat
83	Lumi Vjosa	6/b	Pylli Rromësit	11	Fier Privat
Shuma:				1554.7	
Kullota					
1	Ballsh-Fratar	18	Çoçaj	20	Memaliaj
2	Ballsh-Fratar	43	Margëlliç	111.5	Memaliaj
Shuma:				131.5	



○ Spitali dhe Qëndrat Shëndetsore¹¹

Në Bashkinë Mallakastër ndodhet 1 (një) spital (spitali i Ballshit) dhe 9 (nëntë) Qendra Shëndetësore sipas tabelës së mëposhtme:

	Ballsh	Dukas	Aranitas	Kutë	Ngraçan	Hekal	Greshicë	Fratar	Selitë
Spital	1	0	0	0	0	0	0	0	0
QSH	1	1	1	1	1	1	1	1	1
Ambulanca	0	11	4	4	2	4	2	5	3

Tabela 16- Të dhënat mbi numrin e Spitaleve, Qëndrave Shëndetsore dhe Ambulancave Mallakastër

Stafi i Drejtorisë së Shëndetit Publik në Mallakastër përbëhet nga 15 punonjës, të cilët kanë pozicione të ndryshme si: drejtor, shef shërbimi, sekretare, ekonomiste, mjek epidemiolog, dizinfektor, infermier, shofer, infermiere statistike, k/vaksinatore, specialist e kujdesit infermieror, higjeniste, mjek stomatolog, sanitare.

	Spitali Ballsh	QSH Fratar	QSH Kute	QSH Ngraçan	QSH Dukas	QSH Aranitas	QSH Selite	QSH Greshice	QSH Ballsh	QSH Hekal
Mjek	4	2	1	1	3	1	1	1	3	1
Infermier	25	13	6	3	14	7	4	3	7	5
Shofer	5	2							1	
Sanitare	19	1								

Tabela 17: Të dhënat e stafit përbërës të Qëndrave Shëndetsore Mallakastër dhe Spitalit Ballsh

Sa i përket kapaciteteve mund të themi se vetëm spitali i Ballshit ka kapacitet prej 23 shtetë.

○ Zhvillime ose struktura arsimore, shëndetësore, sociale, kulturore e artistike¹²

Kopshtet

Në shtrirjen gjeografike në Bashkinë Mallakastër ndodhen 33 kopështe me kapacitete fëmijësh si në tabelën e mëposhtme:

Nr	Kopshti	Vendodhja	Kapaciteti (Nr.fëmijësh)
1	Ballsh	Ballsh	65
2	Ballsh	Ballsh	130
3	Usojë	Usojë	20
4	Lavdan	Lavdan	20
5	Dukas	Dukas	20
6	Drenovë	Drenovë	30
7	Drenovë fushe	Drenovë fushe	20
8	Belistan	Belistan	10
9	Visokë	Visokë	30
10	Lapulec	Lapulec	17
11	Kash	Kash	20
12	Hekal	Hekal	50
13	Klos	Klos	30
14	Rromës	Rromës	25
15	Mollaj	Mollaj	25
16	Aranitas	Aranitas	20
17	Panahor	Panahor	30
18	Ngraçan	Ngraçan	15
19	Greshicë	Greshicë	15
20	Gjrbës	Gjrbës	20
21	Kapaj	Kapaj	20
22	Symizë	Symizë	70
23	Bejar	Bejar	36
24	Ninesh	Ninesh	25
25	Drenovë e re	Drenovë e re	20
26	Kutë	Kutë	30
27	5-shkurti	Ballsh	75
28	Drizar	Drizar	30
29	Poçem	Poçem	15
30	Lofkend	Lofkend	17
31	Kremenar	Kremenar	20
32	Ismail Klosi	Ballsh	40
33	Cfir	Cfir	20

Tabela 18: Të dhënat mbi kapacitetin dhe vendodhjen e kopshteve në Bashkinë Mallakastër

¹¹ Burimi i informacionit: Drejtoria e Shëndetit Publik, Mallakastër

¹² Burimi i informacionit: Zyra Arsimore, Mallakastër

Në Bashkinë Mallakastër ndodhen 33 shkolla 9-vjeçare me kapacitete si në tabelën e mëposhtme:

Nr	Shkolla	Vendodhja	Kapaciteti (Nr.nxënësish)
1	5 Shkurti	Ballsh	538
2	Besëlidhja	Ballsh	705
3	Ismail Klosi	Ballsh	824
4	Ismail Klosi	Ballsh	9
5	Kash	Kash	73
6	Usojë	Usojë	0
7	Beqo Caushi	Drenovë	161
8	Visokë	Visokë	146
9	Ngraçie	Ngraçie	16
10	Ali Maskaj	Lofkënd	63
11	Lofkënd	Lofkënd	21
12	Dervish Dekali	Hekal	181
13	Klos	Klos	26
14	Gjysho Karemani	Mollaj	168
15	Mollaj	Mollaj	11
16	Ramiz Aranitasi	Aranitas	129
17	Dino Kalenja	Panahor	120
18	Cfir	Cfir	32
19	Metoh	Metoh	56
20	Ngraçan	Ngraçan	77
21	Ahmet Jazi	Greshicë	117
22	Muharrem Zotaj	Gjerbës	81
23	Fadil Hadushaj	Kapaj	47
24	Gjokë Doçi	Fratar	267
25	Kremenar	Kremenar	25
26	Gjokë Doçi	Fratar	1
27	9 Dëshmorët	Gadurovë	190
28	7 Dëshmorët	Ninësh	111
29	Ismail Shehaj	Kutë	64
30	Ibrahim Shehu	Çorrush	36
31	Dino Ahmeti	Poçem	59
32	Poçem	Poçem	27
33	Universi	Ballsh	10

Tabela 19: Të dhënat mbi kapacitetin dhe vendodhjen e shkollave 9-vjeçare në Bashkinë Mallakastër

Në Bashkinë Mallakastër ndodhen 4 shkolla të mesme me kapacitete si në tabelën e mëposhtme:

Nr	Shkolla	Vendodhja	Kapaciteti (Nr.nxënësish)
1	Dervish Hekali	Ballsh	739
2	Dervish Hekali	Hekal	74
3	Hajredin Fratari	Fratar	881
4	Universi	Ballsh	160

Tabela 20: Të dhënat mbi kapacitetin dhe vendodhjen e shkollave të mesme në Bashkinë Mallakastër

Është i disponueshëm stadiumi i qytetit Adush Muça, fusha e sportit është në rehabilitim në lagjen “5 Shkurti”, qyteti Ballsh, ndërsa fusha e sportit në Njësinë Administrative Fratar është në gjendje të mjerueshme.

Nëpërmjet PPV bashkia do të propozojë:

- Ndërtimin e një shkolle 9-vjeçare me kapacitet prej 800 nxënësish dhe një shkollë të Mesme të Përgjithshme në fshatin Damës, Njësia Administrative Fratar.
- Ndërtimin e një objekti të përbashkët për çerdhe dhe për kopësht me drekë dhe pa drekë për të gjitha grupet e fëmijëve në qytetin e Ballshit.
- Ndërtimin e një Shkolle Profesionale publike për plotësimin e nevojave sipas tregut të punës duke marrë shkas dhe nga burimet natyrore të zonës.
- Ndërtimin e një terreni sportiv në Njësinë Administrative Fratar që do të shërbej për argëtimin e komunitetit të kësaj zone.
- Ndërtimin e një kompleksi sportiv pranë stadiumit ekzistues “Adush Muça” për stërvitjen e

ekipit të futbollit “Bylis” dhe ekipeve zinxhirë.

- Ndërtimi i një spitali me standarte bashkekohore dhe europiane, në pozicionuar në periferi qytetit.



3. KUFIJTË E TERRITORIT TË NJËSISË VENDORE

Bashkia Mallakastër shtrihet në një territor të relativisht të madhë me sipërfaqe të përgjithshme prej 329.19 km².

Ajo kufizohet në veri nga Bashkia Patos dhe Bashkia Roskovec, në lindje me Bashkinë Berat, në jug-lindje me Bashkinë Memaliaj, në jug- perëndim me Bashkinë Selenicë dhe në perëndim me Bashkinë Fier.

- *Informacion mbi Njësitë Administrative që përbëjnë Territorin e Bashkisë Mallakastër dhe fshatrat*

Bashkia Mallakastër përbëhet nga 9 (nëntë) njësitë administrative si më poshtë

- | | |
|-------------------------------------|--|
| 1- Njësia Administrative Aranitas, | 6- Njësia Administrative Qendër Dukas, |
| 2- Njësia Administrative Greshicë, | 7- Njësia Administrative Selitë, |
| 3- Njësia Administrative Hekal, | 8- Njësia Administrative Ballsh |
| 4- Njësia Administrative Kutë, | 9- Njësia Administrative Fratar |
| 5- Njësia Administrative Ngraçan, . | |

- *Pretendimet mbi kufijnjtë Territoriale pas ndarjes së re Territoriale*

Kufiri i bashkisë Mallakastër është kufiri i miratuar në Ligjin Nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”. Nëpërmjet projekteve STAR dhe STAR 2, Qeveria Shqiptare po zhvillon procesin e saktësimit të kufijve administrativ të bashkive pas ndarjes së re administrative-territoriale.

Për efekt planifikimi, dokumenti i Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Mallakastër do të përdorë të mbivendosur me të, edhe “kufirin e planifikimit”, që do të përmbledhë kufirin administrativ zyrtar, pretendime të mundëshme të bashkive kufitare dhe luhatje të mundëshme të kufijve, kjo me qëllimin për të planifikuar territorin maksimal që mund të kalojë nën administrim bashkisë në përfundim të procesit të saktësimit të kufijve.

Këto kufij, në mungesë të një harte zyrtare administrative janë diskutuar në një proces të hapur me Pushtetet vendore kufitare, dhe ndonëse nuk ka një marrëveshje të zyrtarizuar, harta në vijim është rezultati i këtyre diskutimeve.

Bashkia Mallakaster




Figura 8:Harta e territorit administrativ të bashkisë

13

¹³ Burimi i informacionit: AKPT

4. PLANI I VEPRIMIT PËR HARTIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR PËR BASHKINË MALLAKASTËR

a. Fazat dhe hapat kryesore:

Menjëherë pas miratimit të nismës për hartimin e PPV Bashkia Mallakastër, do të bëhet njoftimi i palëve të interesuara. Dokumenti i Nismës së bashku me aktin e miratimit do të botohen në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit (RKPT) dhe sipas mjeteve tradicionale të informimit. Hapat më kryesorë janë si më poshtë:

- a. Bashkia Mallakastër do të sigurojë një proces dialogu, bashkëpunimi dhe bashkërendimi, horizontal e vertikal, me çdo autoritet të planifikimit e palë të interesuar, përpara fillimit dhe gjatë procesit të hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor.
- b. Bashkia Mallakastër dhe studioja, e cila do të asistojë bashkinë në hartimin e PPV (përzgjedhur sipas procedurave të tenderimit) këshillohet me AKPT-në dhe palët e interesuara. Bashkia i vë në dijeni rregullisht të interesuarit për ecurinë e procesit, nëpërmjet botimeve në regjister;
- c. Kryetari i Bashkisë stimulon dhe mbështet ngritjen e Forumit Këshillimor Vendor (FKV) për t'u konsultuar lidhur me çështjet dhe zhvillimet kryesore, të tilla si: planifikimi urban, planifikimi strategjik për zhvillimin ekonomik, buxheti, paketa fiskale dhe ofrimi i shërbimeve;
- d. Bashkërendimi i dokumentit të planifikimit do të zhvillohet nëpërmjet mekanizmit të Forumit për Bashkërendimin e Planifikimit në nivel Vendor (FBPV);
- e. Takimet këshilluese do të zhvillohen me grupet e interesit dhe ekspertet e fushës. Takimi publik zhvillohet me një publik të gjerë. Bashkia do të organizojë të paktën një takim këshillues dhe një takim informues për publikun. Përmbledhja e vërejtjeve apo propozimeve të shprehura gjatë takimeve këshilluese dhe atyre informuese me publikun i bashkëlidhen dokumentit të planifikimit;
- f. Shpallja e çdo takimi ose seance këshillimi dhe dëgjimore publike do të botohet në Regjister, krahas dërgimit të ftesave zyrtare për institucionet dhe aktorët. Rezultatet e takimeve gjithashtu do të publikohen në regjister, bazuar në detyrimet ligjore.
- g. Çdo autoritet planifikimi, institucion, grup interesi dhe aktor që merr pjesë në këshillime/dëgjesa publike apo është i interesuar për PPV-në, mund të paraqesë qëndrimin e tij zyrtar sipas parashikimeve ligjore. Komentet dërgohen zyrtarisht me shkrim dhe përmbajnë argumente të qarta lidhur me qëndrimin përkatës, si edhe sugjerime për Konsulentin. Nëse nuk dërgohen komente, merret i mirëqenë miratimi i pjesës së diskutuar. Trajtimi i komenteve bëhet sipas udhëzimeve ligjore në fuqi.
- h. Pasi të konsiderohet si përfundimtar, dokumenti i PPV-së do t'i dërgohet AKPT-së për procedurën e vlerësimit final dhe miratimit nga KKT-ja.

5. MËNYRËN E MIRATIMIT TË PPV: NË NJË APO DY NDALESA

Miratimi i planit do të kryhet me **një ndalesë**. Kjo nënkupton miratimin njëkohësisht të Strategjisë Territoriale dhe Planit të Zhvillimit Territorial.



AKPT bën vlerësimin teknik të dokumentit të hartuar për çdo fazë dhe me hartimin e dokumentit të plotë të PPV, bashkia bën kërkesë zyrtare për lëshimin e Aktit të Përputhshmërisë nga AKPT.

Përpara miratimit të Planit të Përgjithshëm Vendor ai duhet të pajiset me Aktin e Përputhshmërisë nga AKPT dhe Deklaratën Mjedisore lëshuar nga Ministri i Mjedisit. Pajisja me Deklaratë Mjedisore do të ndiqet nga Bashkia e Mallakastrës sipas legjislacionit në fuqi, duke zbatuar të gjitha hapat e miratimit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor, paralel me procedurën e sipërpërmendur të hartimit dhe miratimit të PPV-së.

6. PËRMBAJTJA E DOKUMENTIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR

Përmbajtja e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Mallakastër do të bazohet në nënin 54 të VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, konkretisht, Plani i Përgjithshëm Vendor përmban:

- Informacionin e plotë gjeohapësinor për territorin e integruar në platformën GIS, sipas standardeve të Regjistrat Kombëtar të Planifikimit të Territorit, për secilën pikë në vijim.
- Analizën dhe vlerësimin e territorit, ku përfshihen:
 - a) analiza e legjislacionit dhe dokumenteve të planifikimit pararendës;
 - b) analiza e përgjithshme e territorit;
 - c) analiza e përdorimit të tokës;
 - ç) analiza socioekonomike;
 - d) hartat shoqëruese.
- Strategjinë territoriale, ku përfshihen:
 - a) gjetjet e analizës dhe të vlerësimit të territorit;
 - b) vizioni, objektivat strategjike dhe drejtimet e zhvillimit;
 - c) programet dhe projektet e zhvillimit;
 - ç) plani i veprimeve për zbatimin e projekteve;
 - d) hartat shoqëruese.
- Planin e zhvillimit të territorit, ku përfshihen:
 - a) plani i përdorimit të tokës;
 - b) plani i infrastrukturave dhe i shërbimeve publike;
 - c) plani i mbrojtjes së mjedisit;
 - ç) plani i veprimtimit për zbatimin e PPV-së;
 - d) hartat shoqëruese.
- Rregulloren e planit, ku jepen:
 - a) përkufizimet e termave dhe shpjegimet e kodifikimit;
 - b) rregullat e përgjithshme të përdorimit të tokës;
 - c) rregullat për çdo njësi;
 - ç) rregullat për infrastrukturën;
 - d) rregullat për ruajtjen e mjedisit, peizazhit, burimeve natyrore dhe objekteve të trashëgimisë kulturore.
- Vlerësimin strategjik mjedisor, referuar legjislacionit të posaçëm në fuqi.

Hartimi i strategjisë së territorit do të përmbajë parashikimet e detyrueshme që rrjedhin nga Plan i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit, Planet Kombëtare Sektoriale, Plane Sektoriale në Nivel Qark, të cilat janë në fuqi apo në proces hartimi.



i. Analiza dhe vlerësimi i territorit

Analiza do të zhvillohet në dy nivele, analiza metabolike e flukseve dhe analiza e thelluar e territorit që do të përdoret për të evidentuar elementët e fortë dhe ato të dobët të Bashkisë dhe në bazë të tyre për të vlerësuar mundësitë e zhvillimit të ardhshëm.

Analiza dhe vlerësimi i territorit e ndërtuar mbi të dhënat e përgjithshme, synon të evidentojë:

- Raportin e bashkisë me rajonin, qarkun dhe me territorin përreth bashkive fqinje;
- Efektet që vijnë nga ndikuesit territorial natyral si fiziografia, hidrografia, karakteristika të veçanta natyrore (deti, kodrat), etj; dhe artificiale, si afërsia me aksin rrugor Levan-Tepelenë që përshkon territorin e Mallakastrës, etj.

Analiza e thelluar do të bazohet në 2 elementë:

- Analiza e inventarit të Bashkisë;
- Evidentimi dhe vlerësimi i elementeve kyç të territorit.

ii. Strategjia dhe Vizioni i zhvillimit të bashkisë

Bazuar në rezultatet e analizës, do të hartohet Strategjia Territoriale e Bashkisë. Është e nevojshme që programet publike për të promovuar dhe akomoduar zhvillimin e ardhshëm të bashkisë të bazohen në parashikimet për rritjen e ardhshme të popullsisë. Parashikimet për popullsinë mundësojnë vlerësimin e investimeve të nevojshme për të akomoduar nevojat dhe kërkesat e popullsisë së ardhshme për strehim, shërbime publike, punësim, dyqane, aktivitete rekreative, etj, si dhe mobilitetin. Megjithatë, parashikimet për rritjen e popullsisë nuk përbëjnë një bazë të mjaftueshme për planifikimin e zhvillimit të ardhshëm. Përtej përmbushjes së nevojave, lindin pyetje që kanë të bëjnë me cilësinë e jetës që duan të arrijnë njerëzit, si dhe prioritetet relative të kërkesave të ndryshme.

Çdo dokument zhvillimi paraprihet nga një vizion. Hartimi i një vizioni që do të përfshijë në vetvete të gjithë spektrin e çështjeve që i përkasin këtij projekti, është një nga sfidat kryesore të këtij projekti.

iii. Plani i Zhvillimit Territorial

Plani i Zhvillimit Territorial do të përcaktojë zhvillimin e ardhshëm në të gjithë Bashkinë Mallakastrë. Plani përkthen në dokument rregullator planifikues direktivat e strategjisë së zhvillimit, duke treguar mënyrën e realizimit të tyre, duke shprehur parashikimet që kanë autoritetet për të ardhmen e territorit, organizimin e hapësirave të tij, sistemin e transportit, zgjerimin e ardhshëm, ambientet kryesore të shërbimeve, zonat e mbrojtura, etj, dhe duke shpjeguar ndryshimet apo përmirësimet kryesore që autoritetet kanë si qëllim të arrijnë në fushën e zhvillimit urban të qytetit.

PPV-ja është një dokument statutor, i cili me anë të Rregullores së zbatimit të PPV-se u jep mundësinë autoriteteve publike të rregullojnë të drejtat dhe detyrimet që lidhen me pronësinë mbi pasurinë e patundshme, specifikon qëllimet publike lidhur me zhvillimin urban dhe koordinon veprimtarinë publike me atë të pronarëve privatë të tokës, me qëllim që të mbrojë, dhe nëse është e nevojshme sipas parashikimeve ligjore, të “imponojë” interesin kolektiv.

iv. Rregullorja e Planit

Rregullorja e Planit do të përmbajë përkufizimet e termave dhe shpjegimet e kodifikimit siç është rregulla të përgjithshme të përdorimit të tokës, rregulla për çdo njësi, rregulla për infrastrukturën, rregullat për ruajtjen e mjedisit, peisazhit, burimeve natyrore dhe objekteve të trashëgimisë kulturore, etj.

v. Hartimi i studimit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor

Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor do të realizohet nga studioja që do hartojë Planin e Përgjithshëm Vendor, e cila ka në përbërje të saj dhe specialistë të mjedisit, sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin Nr. 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”.

VSM ofron një vlerësim të qëndrueshmërisë mjedisore të Planit të propozuar. Në mënyrë të veçantë, ky raport identifikon çdo efekt mjedisor negativ që mund të ketë plani vendor dhe sugjeron masat për zbutjen e tyre. VSM hartohet bazuar në vlerësimin tërësor të situatës mjedisore ekzistuese. Proçesi i përpunimit të Planit Vendor, rezultatet dhe rekomandimet e tij do të testohen sipas një numri kriteresh mjedisore. Kriteret do të përfshijnë planifikimin hapësinor, ndryshimet klimaterike, demografinë, përdorimin e tokës, mbrojtjen e zonave të gjelbra, zbutjen e ndikimeve të fatkeqësive natyrore, infrastrukturën, strehimin, transportin, cilësinë e ujit dhe ajrit, biodiversitetin, shëndetin, standardet dhe përputhshmërinë me planet e tjera dhe kriteret e tjera që do të dalin nga analiza e thelluar.

7. EKSPERTËT (FUSHAT E EKSPERTIZËS) QË DO TË PËRBËJNË GRUPIN E PUNËS QË DO TË HARTOJNË PPV-NË

Përsa i përket organizimit të strukturave të përfshira në procesin e hartimit të PPV-së, dokument i planifikimit do të hartohet nga një grup ekspertësh që do të përzgjidhet me procedurën e prokurimit publik, realizuar nga Ministria përgjegjëse për planifikimin e territorit. Proçesi i hartimit të PPV do të bashkërendohet edhe me Ministrinë përgjegjëse në fushën e turizmit, bujqësisë, mjedisit, infrastrukturës, transportit, energjisë, bashkitë fqinje dhe çdo strukturë tjetër që mund të jetë palë e interesuar për zhvillimet në territorin e Bashkisë.

Stafi i bashkisë, i cili do të japë kontributin e tij në hartimin e dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor është evidentuar si më poshtë:

- | | |
|-----------------------------|--|
| 1- Hajredin Serjanaj | <i>N/Kryetar;</i> |
| 2- Aleksandër Rama | <i>Drejtor i Drejtorisë Ekonomike;</i> |
| 3- Roven Osmënaj | <i>Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Marrëdhënieve me Publikun;</i> |
| 4- Arjan Llanaj | <i>Drejtor i Drejtorisë së Çështjeve Sociale;</i> |
| 5- Aurora Naka | <i>Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit të Territorit;</i> |
| 6- Enea Aliaj | <i>Drejtor i Drejtorisë së Mjedisit;</i> |
| 7- Erjon Çelaj | <i>Drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës;</i> |
| 8- Besjana Velaj | <i>Ing. Hidroteknik.</i> |

Bashkia Mallakastër si autoritet përgjegjës për planifikimin siguron një proces dialogu, bashkëpunimi dhe bashkërendimi, horizontal e vertikal, me çdo autoritet të planifikimit e palë të interesuar, në fillim të procesit dhe gjatë hartimit të dokumentit vendor të planifikimit.



Bashkia Mallakaster ka evidentuar krahas strukturave ne nivel qendror (ministri e institucione varesie) dhe strukturat në nivel lokal që luajnë rolin e paleve të interesuara dhe preken ose mund të kontribuojnë në zhvillimin territorial të Bashkisë Mallakastër të listuara si më poshtë:



1. Bordi i Kullimit;
2. Kombinatai i Përpunimit të Thellë të Naftës;
3. Shoqata lokale;
4. Biznese lokale;
5. Grupe interesi në vartësi të çështjeve

8. PËRCAKTIME PËR FORUMIN KËSHILLIMOR VENDOR

Forumi Këshillimor Vendor do të përbëhet prej Shoqërisë Civile, grupeve të interesit, personave dhe intelektualëve të profesioneve të ndryshme, që i kanë dhënë dhe i japin qytetit të Ballshit dhe bashkisë në përgjithësi, shoqëritë e ndryshme që operojnë në territorin e bashkisë. Ky forum do të mbledhet një herë në muaj, në prezencë të Kryetarit të Bashkisë dhe stafit të bashkisë dhe do të shqyrtojë herë pas here ecurinë e hartimit të PPV për Bashkinë Mallakaster. Gjatë mbledhjeve të Forumit Këshillimor Vendor do të diskutohen dhe do të jepen mendime e ide të ndryshme për hapa të ndryshëm të hartimit të PPV, si dhe për realizimin e objektivave dhe detyrave të ndryshme në përputhje me të gjithë faktorët që do të përfshihen në hartimin e PPV.

9. PËRCAKTIME PËR PROCESIN E BASHKËRENDIMIT, KËSHILLIMIT DHE TAKIMEVE PUBLIKE

Gjatë hartimit të dokumentit të planifikimit është tepër e rëndësishme të sigurohet një proces dialogu, bashkëpunimi dhe bashkërendimi ndërmjet autoriteteve qeverisëse dhe komunitetit, me synim harmonizimin e trajtimit të çështjeve të rëndësishme kombëtare dhe vendore, të fushave e sektorëve të ndryshëm në planifikimin e territorit.

Mbështetur në nenet 5 dhe 6 të VKM-së Nr. 686/2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", bashkërendimi horizontal ndërmjet autoriteteve kombëtare të planifikimit dhe bashkërendimi vertikal ndërmjet autoriteteve kombëtare dhe atyre vendore, janë përgjegjësi funksionale e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT).

Në këtë kuadër, autoriteti përgjegjës i planifikimit pranë Bashkisë Mallakastër parashikon të organizojë 4 (katër) ose më shumë seanca takimi publik dhe këshillimi përpara çdo vendimarrjeje. Këto takime publike parashikohet të organizohen në Bashkinë Mallakastër si dhe në disa njësi administrative përbërëse të kësaj Bashkie, sipas rastit dhe nëse shihet e nevojshme.

Rezultatet, komentet dhe propozimet e takimeve publike do të reflektohen dhe do t'i bashkëlidhen dokumentit të planifikimit.

10. BUXHETI PËR HARTIMIN E PPV

Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Mallakastër do të hartohet me mbështetjen financiare dhe teknike të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Kontributi financiar i Bashkisë lidhet me angazhimin e stafit të saj në procesin e grumbullimit të informacionit dhe organizimin e aktiviteteve publike, si dhe detyrimeve të veçanta financiare kërkuara me ligj, si rishikimi i dokumentit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) nga Ministria e Mjedisit.



11. ZHVILLIMI NË TERRITORIN E BASHKISË DERI NË MIRATIMIN E PPV

Deri në miratimin e Dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Mallakastër, zhvillimi në territorin e bashkisë do të kryhet në përputhje me Vendimin Nr. 1, datë 30.07.2015 të Këshillit Kombëtar të Territorit *“Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi deri në miratimin e planeve të përgjithshme vendore”*.

Nga ana e bashkisë nuk është marrë asnjë vendim për pezullimin e zhvillimit të territorit të njësisë vendore.

Znj. Aurora NAKA

DREJTOR

Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Bashkia Mallakastër